

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 218, Dhjetor 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Gëzuar për shumë mote Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2022



**REALIZIMET E VITIT 2021,
PAVARËSISHT SITUATËS SË
PANDEMISË, MENDOJMË SE
DO TË JENË NJË BAZË NISJE
2 E MIRË, PËR TË VIJUAR
REALIZIMIN E MISIONIT TË
SHOQATËS, NË VITIN 2022**

Në Deçan - Në nderim të Demë Ali Pozharit e tribunëve të kombit

Në këtë veprimtari përkujtimore kushtuar vitit të atdhetarit e luftëtarit Demë Ali Pozharit e tribunëve të tjerë të kombit: Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Dreshaj, të cilët gjatë gjithë jetës së tyre kontribuan dhe sakrifikuan që Shqipëria të jetë e lirë dhe e Bashkuar, e organizuar nga Shoqatën e Vëllazërisë Kosovë Malësi e madhe "Martin Dreshaj", në bashkëpunim me komunën e Deçanit, me ftese të grupit organizator, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me datën 18 dhjetor 2021, mori pjesë grupi i përberë nga: Ndue Sanaj-Kryetari, Prele Milani-Nëkryetari, Kole Çardaku-Anëtar i K. dhe Juli Kosteri.



REALIZIMET E VITIT 2021, PAVARËSISHT SITUATËS SË PANDEMISË, MENDOJMË SE DO TË JENË NJË BAZË NISJE E MIRË, PËR TË VIJUAR REALIZIMIN E MISIONIT TË SHOQATËS, NË VITIN 2022

Anëtar të shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dukagjinat dhe simpatizantë të tyre, Dita e lindjes së Jezuesit po vjen dhe ardhhtë e bardhe, se me siguri do të lind një ditë e re për ne dukagjinat e gjithë shqiptaret kudo janë.

Të dashur, viti 2021 po mbyllet, edhe pak ditë janë, i cili jo me pak probleme po mbyllet dhe që vijojnë të jene prezentë për efekt të Pandemisë. Megjithatë, në këto kushte edhe kemi përgatitur e zhvilluar disa veprimtari.

Ato janë: Së pari, botimi gazetës “Dukagjini” ka vijuar të botohet në çdo muaj, në saj të punës së palodhur të redaksisë së gazetës me në krye Luigj Shyti dhe i dashamirësve të saj, që nuk janë pak. Në këtë muaj, del numri 218 i saj. Për botimin e saj, është dhe kontributi i pakursyer të dukagjinave kudo ndodhur, si Edmira e Luigi Mazzo nr. 207, Kujtim Funiçi nr. 208 e 209, Preke Gjonaj nr. 210, Preke Gjonaj e Sokol Sterbyqi nr. 211, Mhill Shkambi nr. 212, Agron Hasanaj nr. 213, Fran Shytani nr. 214, Tome Arra nr. 215, Agostin Aramadhni nr. 216, Shan Staka nr. 217 dhe Vate Dema nr. 218. Për botimin e gazetës, gjate vitit, gjithsejtë janë financuar 246 000 leke, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë, me urimin popullor “Paçi e dhënçi!”

Së dyti, me datën 11 prill 2021, ditë e Diele, në mjediset e Bar-Restorant “TRADITA”, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” organizoi veprimtarinë përkujtimore, me temë: “80-vjetori i Luftës së Gurit të Kuq”, me nismën e studiuesit e N/kryetarit të SHAD, Prele Milani e ndihmësin Lulash Brigja, për cilën patëm mbështetjen e ndihmën e Gjon Dukgilaj, pronarit të Bar-Restorant “Tradita”. Për realizimin e kësaj veprimtarie kontribuuan Anton Kosteri, Agron Hasanaj, Gjergj Leqejza e Genc Çardaku, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë “Paçin e dhënçin përsëri!”.

Së treti, me datën 12 qershor 2021 morëm pjesë në konferencën përkujtimore të 110 vjetorit të ngritjes së Flamurit Kombëtar në Deçiq dhe të 22 vjetorit të Çlirimit të Kosovës, të organizuar nga Shoqata e Miqësisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, në Rugova-Kamp, në të cilën Ndue Sanaj mbajti një trajtesë, me temë “Kontributi i Republikës së Shqipërisë në Çlirimin e Kosovës” dhe poeti Lulash Brigja recitoi një poezi kushtuar Kosovës, me titull “KAM PA NJË ËNDËRR...”. Për marrjen pjesë në këtë veprimtari kontribuoj Lulash Gjeloşi, pronari i Bar-Restorant “FLOGA”, të cilin e falënderojmë dhe i urojmë, pastë e dhentë!

Së katërti, me datën 26 qershor 2021 morëm pjesë në veprimtarinë e VIII të Ditës së Plisit, të organizuar nga katërshja e zakonshme, shkrimtari Prende Buzhala, piktori Idriz Berisha-Xhixhi e Gjon Gjergjaj-Poet e skulptor, me në krye aktorin Ismet Krasniqi-Lala, në fshatin Stankaj të Rugovës. Në këtë veprimtari, me propozim të Ismetit dhe me vendim

nr. 261, datë 23 qershor 2021, u nderuan me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, Prof. Dr. Zymer U. Neziri dhe doktor Frrok Kristaj; u nderua me titullin me titullin “Mirënjohja Mehmet Shpendi” dëshmorit avokat Bajram Kelmendit, pas vdekjes, dhe me titullin “Mirënjohja Martin Camaj” u nderua profesor Tahir Bezhani, doktor Sejdi Berisha dhe poeti Gjon Gjergjaj. Në emër të Shoqatës përshëndeti Ndue Sanaj dhe poeti Lulash Brigja recitoi poezinë me titull “SHQIPËRINË ETNIKE UNË DO TA JETOJ”. Rapsodi Gjeloşi Fuşa këndoi këngën lirike, me titull “Ka ra dielli në shpat a' luge”. Për marrjen pjesë në këtë veprimtari kontribuo sekretari i Shoqatës dhe kryetari i avokatisë Shkodër, avokat Anton Kosteri, të cilin e falënderojmë për kontributin e tij.

Së pesti, me datën 4 shtator 2021, në bibliotekën “Luigj Gurakuqi”, u organizua dhe u paraqit libri, me titull “Kujtimet e një ushtaraku” (45 vite jetë ushtarake), me autor Ndue Sanaj. Shpenzimet e kësaj ceremonie u mbuluan nga autori.

Së gjashti, me 11 shtator 2021, morëm pjesë në ceremoninë e varrosjes të kantautorit Mhill Çun Gjonaj, që në muajin shkurt të këtij viti e kemi propozuar për ta dekoruar me urdhrin “Mjeshtër i Madh”. I mbështetur dhe nga kryetarja e bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi dhe jemi në pritje të dekorimit të tij, pas vdekjes.

Së shtati, me datën 27 shtator 2021, morëm pjesë, me kryetarin e këshillit të shoqatës, avokatin Agim Martini (Gila) në inaugurimin e monumentit të Shenjtares Nënë Tereza, në afërsi të qafës së Thanës, fshati Sumë, të realizuar e të organizuar nga familja Vocaj-Sahatçija. Në emër të Shoqatës u vu kurorë pranë monumentit dhe u përshëndeten pjesëmarrësit. Për marrjen pjesë në këtë inaugurim, mbuloi shpenzimet Gjon Dukgilaj, pronari i Bar-Restorant “Tradita”, të cilit i themi “T”u rrite ndera Gjon Dukgilaj!”

Së teti, me 23 tetor 2021, morëm pjesë në paraqitjen e librit, me titull “Një jetë me këngë” të autorit Fran Kodra, në të cilin janë 600 këngë, me tekst e muzikë. Ceremonia u zhvillua në bibliotekën “Marin Barleti”, në bashkëpunim me shoqatën e shkrimtareve e artisteve të Shkodrës.

Së nënti, me 24 tetor 2021, me Prele Milanin, Aleks Dushin, Luigj Milen e Lulash Brigjen, morëm pjesë në veprimtarinë e Festës së Gështenjës të krahinës së Shllakut, që u zhvillua në fshatin Uk-bibaj. Shpenzimet e marrjes pjesë u mbuluan nga Prele Milani.

Së dhjeti, me 30 tetor 2021 morëm pjesë në 50 vjetorin e “Takimeve të Gjeçovit”, me Lulash Brigjen e Maritan Spahin. Me këtë rast përshëndeti Ndue Sanaj dhe në emër të Shoqatës u dorëzua këtij grupi, “Takimet e Gjeçovit” titulli i nderit “Mirënjohja Martin Camaj”, me nr. 262, datë 27 tetor 2021.

Mbuloi shpenzimet e marrjes pjesë në këtë veprimtari anëtar i kryesisë, Marjan Ndershtiqni, pronari i shtypshkronjës

“Fiorentina”, Meritan Spahia dhe Lulash Brigja, të cilëve ju themi “Ju rritë ndera!”

Së njëmbëdhjeti, me datën 7 nëntor 2021, në bibliotekën “Marin Barleti”, në bashkëpunim me Drejtorin e bibliotekës, Maxhid Cungu, me Shoqatën e shkrimtareve e artisteve të Shkodrës dhe shoqatën atdhetare “Malësia” u organizua paraqitja e librit novele, me titullin “Marash Tuci, ndorja shqiptare”, të autorit tashmë të mirënjohur Prele Milani, për të cilin mundësoj Prele.

Së dymbëdhjeti, me datën 10 nëntor 2021, morëm pjesë në simpoziumin, me temë “Xhubleta, pasaporta e identitetit kulturor kombëtar” e organizuar nga Shoqata kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, në bibliotekën “Luigj Gurakuqi”, në të cilën Prele Milani mbajti temën “XHUBLETA E DY TRAJTËSHME E MALËSISË SË MADHE DHE DUKAGJINIT” me mjaft referenca shkencore, që pati mjaft urime.

Së trembëdhjeti, me datën 17 nëntor 2021, me Shoqatën kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, në bashkëpunim me Konsullatën e Austrisë të Nderit në Shkodër, në mjediset e bibliotekës “Luigj Gurakuqi” u zhvillua ceremonia “Përkujtimore kushtuar atdhetarit e luftëtarit malësor nga Gruda e Malësisë së Madhe, trimit fisnik Zef Prele Marashi”, sipas librit me titull “Malësore të rritur në kullat e gurit”, të autorit profesor Gjon Frani Ivezaj, të cilin e prezantoi Ndue Sanaj dhe në fund në emër të shoqatës, u dorëzua titulli i nderit “Mirënjohja Mehmet Shpendi” dhanë atdhetarit e luftëtarit Zef Prele Marashi, pas vdekjes, me nr. 263, date 13 / 11 / 2021.

Së katërmëdhjeti, me datën 18 dhjetor 2021, morëm pjesë në veprimtarinë përkujtimore të atdhetarit e luftëtarit Demë Ali Pozharit e tribunëve të tjerë të kombit: Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Dreshaj, me ftesë të kryetarit të Shoqatës së vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, z. Ukshin Jashari, në komunën e Deçanit.

Me këtë rast, për Demë Ali Pozharin, djalit të tij, Ibrahimit, ju dorëzuar titulli i “Mirënjohjes Mehmet Shpendi”, me vendim nr. 264, datë 13 dhjetor 2021. Mundësoj pjesëmarrjen, Sekretari i SHAD dhe Kryetari i Dhomës së Avokatisë Shkodër, Anton Kosteri, të cilin e falënderojmë.

Në përgatitjen e realizimit të këtyre veprimtarive kemi pasur mbështetjen e bibliotekës “Marin Barleti”, të bibliotekës “Luigj Gurakuqi”, të Bashkisë Shkodër, të dukagjinave kudo ndodhur, të cilët i falënderojmë dhe besojmë se edhe në të ardhmen nuk do të na mungojë bashkëpunimi në mes nesh. Gjithashtu kemi pasur mbështetjen e biznesit dukagjinat në Shkodër, si: Bar-restorant “Orlando”, “Floga”, “Tradita”, “Çigako”, “Scutari”, të cilët i falënderojmë dhe ju premtojmë, që nëpërmjet gazetës “Dukagjini” dhe veprimtarive të ndryshme, do të vijojmë më

mirë e më shumë se deri më sot, të bëjmë publikimin e biznesit tuaj.

Gjithashtu na kanë mbështetur: Edmira e Luigi Mazzo në Itali, Kujtim Funiçi, me banim në SHBA, Anton Kosteri, Gjergj Leqejza, Agron Hasanaj, Mhill Shkambi, Fran Shytani, Genc Çardaku, Tome Arra, Agostin Aramadhni, Shan Staka, me banim në SHBA dhe Vate Dema, si dhe Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Mirash Lallinaj, Luvigj Lallinaj, Besnik Arrinaj, Kristian Qershia, Nikoll Gerla, Angjelin Rashkadoli dhe Arben Toma, të gjithë me banim në Kanada. Me shumën e përgjithshme 413 905 leke. Prej tyre, 246 000 leke janë harxhuar për botimin e gazetës “Dukagjini”. (12 numra x 20 500 leke numri = 246 000 leke). Shuma prej 71 600 leke është shpenzuar për realizimin e veprimtarive që janë zhvilluar. Janë në gjendje arke 96 305 leke. Të gjithë i falënderojmë, që nga financa e tyre, kane kursyer për të mbështetur Shoqatën financiarisht, në punën, për të realizuar misionin e saj. Besojmë, që kontributi i tyre, por dhe të tjerëve nën shembullin e këtyre, të kursejnë diçka në interes të punës së shoqatës, për të realizuar misionin e saj edhe në të ardhmen, gjate vitit 2022.

Të nderuar, për vitin 2022, Kryesia e Shoqatës, nuk ka bërë ndonjë plan perspektiv, për efekt të situatës së Pandemisë, se ende nuk dihet ecuria e saj, por mendojmë:

1-Njerrjen e gazetës “Dukagjini”, në çdo muaj, me 16 faqe dhe me 300 kopje, që po të thuash jepet falas.

2- Një takim me nxënësit më të mirë dukagjinat, me rastin e 7 marsit, me datën 2 ose 3 mars 2020.

3- Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge, veçanti në Manifestimin “Zëri i Vëllazërisë-2022”, që organizohet nga Shoqata “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, në muajin Prill 2022 dhe në atë “Dita e Plisit, me qendër në Klinë.

4- Rivendosja e monumentit të albanologut Martin Camaj, me 21 korrik 2022

5- Gjate vitit mund të kemi veprimtari përkujtimore, të paraqitjes së librit dhe të tjera.

Pra, për të vijuar punën Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në realizimin e misionit të saj dhe gjatë vitit 2022, duhet kontributi financiar i të gjithëve, me rreth 1 328 000 leke.

Së pari, kontributi intelektualëve dukagjinat, me ide e pjesëmarrje të tyre.

Së dyti, kontributi i biznesmenëve dukagjinat, se pa kontributin e tyre financiar nuk mund të përgatitën e realizohen këto veprimtari në funksion të realizimit të misionit të shqotës.

Besojmë në kontributin e tyre!

NDUE SANAJ,
Kryetari i Shoqatës Atdhetare
“Dukagjini”

Në Deçan - Në nderim të Demë Ali Pozharit e tribunëve të kombit

Në këtë veprimtari përkujtimore kush-tuar vitit të atdhetarit e luftëtarit Demë Ali Pozharit e tribunëve të tjerë të kombit: Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Dreshaj, të cilët gjatë gjithë jetës së tyre kontribuuan dhe sakrifkuan që Shqipëria të jetë e lirë dhe e Bashkuar, e organizuar nga Shoqatën e Vëllazërisë Kosovë Malësi e madhe "Martin Dreshaj", në bashkëpunim me komunën e Deçanit, me ftese të grupit organizator, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me datën 18 dhjetor 2021, mori pjesë grupi i përberë nga: Ndue Sanaj-Kryetari, Prele Milani-N/kryetari, Kole Çardaku-Anëtar i Kryesisë dhe Juli Kosteri.

Veprimtaria u organizua në sallën e këshillit komunal të Deçanit.

Merrni pjesë plotë veprimtarë, por kryesisht familjaret e atdhetareve e luftëtareve, zoti Ramush Haradinaj, kryetari i komunës zoti Bashkim Ramosaj e të tjerë.

Veprimtaria filloi me HYMNI I FLAMURIT KOMBËTAR!

Prezantoi programin e kësaj veprimtarie koordinatori i saj, Ali Tahiraj.

Përshëndeti kryetari i komunës zoti Bashkim Ramosaj. Fill pas fjalës përshëndetëse të zotit Bashkim, hyri në sallë, pa i prezantuar kush, me valle Ansambli "RUGOVA", i cili paraqiti një numër shumë domethënës, atë të ngritjes së Flamurit.

Pastaj filloi ligjërimi i disa kumtesave: 1-Fation Mehmetaj, i cili prezantoi kumtesën për Demë Ali Pozharin.

2-Valdet Hyseni, i cili prezantoi punimin e Dr. Ilir Kelmendi për tribunin Rugovas, Sali Rama

3- Isuf Mavraj, i cili prezantoi kumtesën për Heroin e Kombit, Mehmet Gradica.


4-Ali Daci, i cili prezantoi kumtesën Bik Dreshaj i Shehrit të Ri

5-Veprimtarine e përshëndeti z. Ramush Haradinaj.

6-Përshëndeti Ndue Sanaj, në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe të grupit pjesëmarrës dhe në fund komunikoj vendimin e kryesisë së SHAD, që miratoj propozimin e kryetarit të Shoqatës "Martin Dreshaj", zotit Ukshin Jashari, për nderimin e atdhetarit e luftëtarit Deme Ali Pozhari, i cili u nderua me titullin "Mirënjohja Mehet Shpendi", me motivacion: "Atdhetarit të shquar, luftëtarit të paepur, që bëri kauzë të jetës çështjen kombëtare për bashkimin e shqiptarëve, kudo që jetojnë, në trojet e tyre", i cili ju dorëzuar djalit të tij, zotit Ibrahim Deme Pozhari.

Pas mbylljes së kësaj veprimtarie përkujtimore, u takuam me kryeartin e komunës, z. Bashkim, me z. Ramush e të tjerë dhe bëmë disa fotografi. Madje z. Ramush, Prele Milani, i dhuroj librin me titull "MARASH TUCI NDORJA SHQIPTARE, takohet e probatinohet me trimin e UÇK-së Ramush Harejdinaj. Burri shkon te burri!"

Zoti Ramush Haradinaj, me këtë rast nderoj me medaljonin e tij personal, me mbishkrimin: "***ME BESIMIN NE



ZOT, ATDHE E SHTET*Ramush Haradinaj**, N/kryetarin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe autorin e librit, Prele Milani.

Pastaj organizoret me kontributin e Komunës, na shtruan një dreke shumë vëllazërore.

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë veprimtari zoti Anton Kosteri, Sekretari i shoqatës dhe kryetari i Dhomës së Avokatishë Shkodër, të cilin e falenderojmë për kontributin e tij të vijueshëm!

Kush është Deme Ali Pozhari?

Demë Ali Pozhari u lind më 1905, në fshatin Pozhar të Deçanit. Arsimin fillestar e bëri në Kosovë, ndërsa Gjim-



nazin Jezuit e vazhdoi në Shkodër. Historia e Familjes Pozhari daton që prej tre shekujsh. Stërgjyshi, Ali Rexha, me të vëllanë Bekën, vritet tek Kalaja e Nishit, më 1876. Gjyshi, Mehmet Ali Pozhari, vritet në rrethimin e Sarajave të Avdullah Pashë Drenit, më 6 shtator 1878, në Gjakovë, ku u vra Mehmet Ali Pashë Max-

harri, me origjinë gjermane nga Magdeburgu i Gjermanisë. Babai, Ali Mehmeti, arsimdashës, në shtëpinë e tij u hap shkoll-

la e parë shqipe në Pozhar 1915-18, me mësues Ibrahim Fehmiu, babai i artistit të mirënjohur, Bekim Fehmiu.

Demë Ali Pozhari u lind më 1905, në fshatin Pozhar të Deçanit. Arsimin fillestar e bëri në Kosovë, ndërsa Gjimnazin Jezuit e vazhdoi në Shkodër. Historia e Familjes Pozhari daton që prej tre shekujsh. Stërgjyshi, Ali Rexha, me të vëllanë Bekën, vritet tek Kalaja e Nishit, më 1876. Gjyshi, Mehmet Ali Pozhari, vritet në rrethimin e Sarajave të Avdullah Pashë Drenit, më 6 shtator 1878, në Gjakovë, ku u vra Mehmet Ali Pashë Maxharri, me origjinë gjermane nga Magdeburgu i Gjermanisë. Babai, Ali Mehmeti, arsimdashës, në shtëpinë e tij u hap shkoll-

la e parë shqipe në Pozhar 1915-18, me mësues Ibrahim Fehmiu, babai i artistit të

mirënjohur, Bekim Fehmiu.

Demë Ali Pozhari u shqua nga brezi i tij, qysh në rininë e hershme. Ai ishte pjesë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kontaktet të përhershme mbante me Profesor Ymer Berishën, Gjon Sereçin, Avdi Smajlin, nga Martinaj, Guci, Sadri Çakën, Mehmet Agë Rashkocin, Ukë Sadikun

dhe atdhetarë të tjerë.

Në ballë të nacionalistëve nga Dukagjini, Rugova, Podguri, Drenica e deri në Mitrovicë, u vunë Demë Ali Pozhari e Kurt Abazi, Sak Fazlia e Sali Rama, Mulla Zekë Bërdynaj i Radavcit e Adem Bajraktari i Vranovcit, Ramë Alia e Bajram Gashi i Uçës të Istogut, Miftar e Cen Bajraktari i Llaushës, Shaban Polluzha e Mehmet Gradica të Drenicës.

Më 4 nëntor 1941, forcat çetnike sulmuan Pazarin e Ri (Novi Pazar-in). Për mbrojtjen e Pazarit të Ri dhe të Sanxhakut në tërësi, i cili dikur ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës, u mobilizuan 3.200 luftëtarë nga Kosova, me angazhimin udhëheqës edhe të Haqif Blutës, Xhafer Devës, Pajazit Boletinit dhe të tjerë. Në luftën e Pazarit të Ri ranë 144 dëshmorë nga Kosova, në mesin e tyre ishte edhe Bardhosh Dina Gërvalla, gjyshi i Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës.

Nacionalistët, kombëtarët mbajtën 11 Kuvende. Të parin në Gjakovë, më 1942 e, deri tek i fundit në Mirëditë, më 1945. Plava, Gucia, Rugova, Rozhaja, Tutini, Pazarit të Ri, në rrezik pushtimi nga forcat çetnike serbo-malazeze.

Gjatë luftës ka udhëhequr çetat e Ballit Kombëtar, bashkë me Ramë Binakun e Dashinocit.

Enver Hocha i ktheu në Kosovë djemtë komunistë të shkolluar në Shqipëri, për ta organizuar, kinse, luftën çlirimtare. Epërsia e forcave komuniste vinte në rritje, në raport me forcat nacionaliste.

Demë Ali Pozhari në vitin 1941 operonte në Plavë e Guci. Ai u vu në ballë të rezistencës, për mbrojtjen e Rrafshit të Dukagjinit, kundër forcave çetnike serbo-malazeze, të cilat, bartnin uniformën partizane jugosllave, tashmë, të inkuadruara në Brigada Partizane. Në aleancë me këto formacione kundra-shqiptare ishte edhe Partia Komuniste e Shqipërisë.

Nga viti 1942 deri më 1944, ishte kryetar i Komunës të Rozhajës. Por, kjo nuk e pengoi, për të drejtuar çetat nacionaliste, në mbrojtje të Dukagjinit, Plavës dhe Gucisë, si dhe në Sangjakun shqiptar, që ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës.

Në korrik 1943, vullnetarët nacionalistë të Demë Ali Pozharit dhe të Mehmet Agë Rashkocit, bënë një operacion të suksesshëm, duke vrarë 60 ushtarë në Luftën e Shekullarit. Në muajin tetor 1944, Demë Ali Pozhari me Ali Bajraktarin, u bënë pengesë forcave partizane jugosllavo-shqiptare, duke mbrojtur Junikun.

Nga viti 1944 deri 1948, udhëheqësit ushtarakë të Lëvizjes nacionaliste, kaluan në ilegalitet Numri i luftëtarëve nën armë, ishte zvogëluar dukshëm. Numëroheshin rreth 40 vetë, të cilët përfaqësoheshin nga: Demë Ali Pozhari, Aziz Zhilivoda, (xhaxhai i Kolonel Ahmet Krasniqit), Ndue Përllëshi, Hasan Remniku, Metë Hasani e të tjerë.

Jeta ilegale e Demë Ali Pozharit ishte tejet e vështirë, duke pasur parasysh organizimin e përgjimit dhe përndjekjes komuniste. Konaku i Qelë Shabanit të Becit,

ishte strehë bazë. Lëvizja ndër konaqe, ka qenë me rrezikshmëri të lartë. Intuita, nuhatja, zgjuarësia e Demë Ali Pozharit ka qenë proverbiale.

Goditja e Familjes të Demë Ali Pozharit, ka filluar para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878; ka vazhduar në vitet '30-a të shekullit të kaluar; në vitet '40-a e '50-a, e deri në luftën e fundit në Kosovë. U vranë radhazi vëllezërit e Demës: Meta dhe Rexha. Djali i madh, Miftari, u ekzekutua në vitin 1946, nga rinia e OZNA-s, kur u kthye nga Hasi në Pozhar. Dy djemtë më të vegjël: Brahimi dhe Afrimi u helmuan nga pushtuesi në viti 1950. Familja Pozhari u burgos, për tre vjet radhazi, nga viti 1946 deri 1948, në burgun e Gjakovës, kohë kjo e illegalitetit të Demë Ali Pozharit.

Kulla e Demë Ali Pozharit u dogji katër herë: E dogji turku, Serbia e Kralit, Jugosllavija komuniste dhe Serbia e Millosheviçit. Dhe, përsëri Kulla është ngritur nga hiri i saj.

Vajza e Demës, që mbijetoi, ishte Zyllyhaja, e lindur nga Nifa, bija e Haxhi Bajraktarit të Vranovcit. Zyllyhaja u martua për Avdyll Shalën, në familjen e Rustem Llukës, të shpëngulur në Lugun e Baranit.

Më 1948, Demë Ali Pozhari, me disa bashkëluftëtarë, arritën të ikin në Greqi. Grekërit i ngujuan në një kamp izolimi dhe donin t'i shfrytëzonin për interesa të veta, por, ata nuk pranuan. Pas tre vitesh qëndrimi në Greqi, arritën të vendosën në Turqi. Në Stanboll u martua me Sabahate Shalën, familje e shpërngulur nga Peja në Stanboll, me të cilën lindën djalin Ibrahim, më 1954. Sabahatja u sëmurë dhe vdiq. Dhe, Dema do të martohet me turkeshën Vasfije, një bukuroshe krenare, motër e dy gjeneralëve turk. Demë Ali Pozharit në Stanboll iu besua detyra e shefit përgjegjës për emigracionin.

Takimi me Demë Ali Pozharin

Hotel "Dajti", Tiranë, nëntor 1969, e takova Demë Ali Pozharin. Edhe pse i moshuar, shtaëlartë, me tipare të krenarisë dhe të bukurisë burrërore, rrezatonte kthjelltesë mendore dhe energji trupore. Me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, ishin ftuar bashkatdhetar nga Mërgata, kryesisht, të moshuar, pjesa më e madhe mërgimtarë ekonomikë, të larguar para Luftës së Dytë Botërore, por, edhe ndoca politikë, nga trojet shqiptare jashtë Shqipërisë londineze. Në mesin e tyre ishte edhe Demë Ali Pozhari, që llogaritet si kryenacionalisti i Rrafshit të Dukagjinit, udhëheqës i rezistencës, në mbrojtje të territorit tokësor, në Rrafshin e Dukagjinit dhe të Sanxhakut, përfshi edhe plavë e Guci.

Emrin e udhëheqësit luftarak, Demë Ali Pozharit, për herë të parë e kam dëgjuar nga babai im, Sadri Smajl Zeqiraj. Ai ka qenë punonjës policie përgjatë viteve të Shqipërisë së Bashkuar, në Skënderaj. Dhe, prej andej shoqërues i udhëheqësit nacionalist drenicar, Mehmet Gradica. Në vitin 1942, në Kuvendin e parë të mbajtur në Gjakovë, me pjesëmarrjen e krerëve nacionalistë dhe komunistë, babai im Sadri Zeqiraj, shoqëronte krerët e Drenicës. Bënë përshtypje se në Kuvend marrin pjesë dy vëllezërit, Demush dhe Haki Taha, i pari me krahun nacionalist, i dyti me atë komunist. Demush Taha - Gjakov-



va, është babai i poetit dhe shkrimtarit të njohur Agim Gjakova. Im at kishte takuar Demë Ali Pozharin, i cili, dy vite më vonë, do të bëhej edhe luftëtar i tij.

E ftuar e festës shqiptare ishte edhe Bije (Sabrije) Vokshi, kuadër e luftës, përkrah komunistëve. Familja Vokshi kishte jetuar në Shqipëri në kohën e Mbretërisë. Nipat e Bijës, Asim dhe Xhafër Vokshi ishin shkolluar atje. Në shtëpinë e tyre u themelua Rinia Komuniste Shqiptare. Aty u njohën edhe çifti i mëvonshëm Nexhmije dhe Enver Hoxha. Gjatë luftës Partia Komuniste Shqiptare, vajzat dhe djemtë e Kosovës, të shkolluar në Shqipëri, i nisi, me mision, për organizimin e lëvizjes komuniste në Kosovë. Asimi ishte vranë në Luftën Civile të Spanjës, "për mustaqet e Stalinit", ndërsa Bija me Xhaferin u kthyen në Kosovë.

Për festën e çlirimit, Bije Vokshi arriti më parë në Tiraë dhe u vendos në Hotel "Dajti". Ishim kureshtarë për takimin e parë, që do të kshin, pas një çerek shekulli, me Demë Ali Pozharin, si kundërshtar politik me armë. Ja, biseda e parë, në mes kundërshtarëve politikë të dikurshëm:

- Bije Vokshi: "Demë Ali Pozhari, po të kisha nxënë para 25 vjetëve, do ta zgjidhja lirin më të gjatë për me të varë".

I menjëhershëm ishte reagimi i Demë Ali Pozharit:

- "Bije Vokshi, edhe unë po të kisha takuar në atë kohë, do të zgjidhja dy lisa të gjatë, në afërsi, sa të arrijnë këmbët tuaja, për t'i varë në ata, me kokë poshtë!"

Dhe, me kaq u bë pajtimi i dy kundërshtarëve politikë të luftës, që përfaqësonin dy rryma armike me njëra-tjetrën.

Një armiqësi e hershme në mes familjes Vokshi dhe Pozhari zë fill kur vëllai i Demës, Metë Ali Pozhari, vritet nga një vokshian. Dhe, vrasja e Beqir Vokshit, më 1923, i faturohet Familjes Pozhari, si hakmarrje. Por, e vërteta është se ekzekutimi i Beqir Vokshit është bërë në urdhër të Hasan Prishtinës, dhënë Çetës të Azem Galicës. Dhe, intriga vazhdon, kur vritet vëllai tjetër i Demës, Rexhë Ali Pozhari, i faturohet Familjes Vokshi, por, në fakt ai është vranë nga xhandari sanxhakli Sheh Boshnjaku.

Për kurbanizimin e nusërisë të Bije Vokshit, përkushtimin për të rritur, shkolluar nipërit jetimë, përjetoi një dramë të veçantë jetësore familjare, me burgje, persekutime, internime nga të dy shtetet komuniste, jugosllave e shqiptar, do të shkruajmë një herë tjetër.

Ndonëse të moshuar, Bije Vokshi dhe Demë Ali Pozhari, patën një trajtim mjekë-

sor të zgjatur, gjë që mundësoi ndejen dhe bisedën tonë, aq të dëshiruar. Bacës Demë i rrëfeva për tim atë dhe takimin në Kuvendin e Gjakovës, më 1942, në cilësinë e shoqëruesit të krerëve delegatë të Drenicës. Ai filloi të rrëfente për luftën, për betejat e fituara, por, edhe për luftën e humbur të forcave nacionaliste, sepse u ndodhën në mes zjarrit të komunistëve jugosllavë dhe shqiptarë, "të cilët, njësoj, na trajtuan si armiq dhe na luftuan, bashkarisht, pa mëshirë!"

Është interesante përputhja e ngjarjeve historike në rrëfimet gojore, personale të Demë Ali Pozharit, me trajtimin që u ka bërë ngjarjeve të asaj kohe autori i librit, Shefqet Dibrani "Rrëfime për jetën e Demë Ali Pozharit".

Është përfolur shumë pajtimi i nacionalistit të parë të Dukagjinit, me komunistin e egër shqiptar Enver Hoxhën. Aq më tepër, kur ishte, pikërisht, Demë Ali Pozhari, ai që u priu të 60 bashkatdhetarëve në takimin me diktatorin Hoxha, i fotografuar duke i cikërruar gotat. Jugosllavia do të reagoonte se "Enver Hoxha u pajtua me nacionalistin, armikun e komunistëve jugosllavë e shqiptarë, gjatë luftës". Këtë pajtim Demë Ali Pozhari e shpjegon me vullnetin e mirë dhe nevojën për t'u pajtuar e bashkuar shqiptarët, para sfidave të kohës dhe, në veçanti, në rrethanat pushtuese, që ndodhet Kosova. Dhe, këtë e shprehu botërisht.

Por, diktatorit Hoxhë nuk i pëlqeu, sepse, një vit më vonë, në vizitën e bërë, për herë parë në Tropojë, pas tej 60 viteve jetë, do të deklaronte se "popujt jugosllavë e shqiptarë, kanë derdhur gjakun, së bashku, në të njëjtat fushë-beteja". Pra, kishte filluar flirti, po përtëritej miqësia shqiptaro-jugosllave. Mesazhi ishte i qartë: Kosova duhej të vazhdonte statusin, të mos përmendej, për t'u bërë "mollë shëri".

Demë Ali Pozhari kishte lënë vajzën Zyllyhanë, në Kosovë dhe djalin e pleqërisë, Ibrahim, të lindur në Istanbul. Pleqëria dhe diagnostikimi me një sëmundje të rëndë, bëri që ai të mendojë seriozisht për djalin e vetëm. Dhe, mori vendimin e vështirë, për ta dërguar për shkollim në Shqipëri, me qëllim të shpëtimit nga asimilimi. Edhe kjo mund të jetë një shtysë e pajtimit me Hoxhën e Tiranës. Për këtë nismë ndërmjetësoi Profesor Bujar Hoxha, ministër fuqiplotë në Konsullatën Shqiptare në Stanboll, i biri i Hoxha Kadri Prishtinës.

Baca Demë dhe sidomos, zonja e tij, teta Vasfije, siç e quaja unë, me shkrua-

nin letra, me porosinë për t'u përkujdesur për Ibrahimin e tyre të shumëdashur. Unë mbaja kontakte, fillimisht, me drejtoreshën e Gjymnazit "Ismail Qemali" dhe, më vonë, me atë të Shkollës Pedagogjike "17 Nëntori", e cila vazhdonte traditën e Shkollës Normale "Nëna Mbretëreshë", të kohës së Mbretërisë Shqiptare, vetëm për femra. Transferi i Ibrahimit në këtë shkollë, i vetmi mashkull, ishte për efekt të mësimin më të mirë të gjuhës shqipe.

Në një letër baca Demë me porosiste: Çoi fjalë vajzës time Zyllyhasë në Gjakovë, që mos t'i dërgojë pako me rroba Ibrahimit, se lazdrohet e nuk mëson. Unë e kryeva porosinë. Por, dada Zyllyha përgjigjet: Ah, more vëlla, baba Demë duhet të më kuptojë, se unë kam vetëm një vëlla! Ibrahim është shtatëlartë e bukur, sikur i ati. "Më bëjë baba të të ngjajë!"

Në njëherë nga letrat, teta Vasfije Pozhari, më porosiste që Ibrahim, pas maturës, të vazhdojë studimet në Fakultetin e Mjekësisë, Dega Stomatologji (Dentari), sepse turkesha Vasfije ëndërronte Klinikë Dentare private, për djalin Ibrahim Pozhari. Dhe, unë i premtova. Por, premtimi mbeti pengun im, sepse humba lirinë dhe komunikimin, njëkohësisht. Ibrahim mbaroi Mjekësinë e Përgjithshme dhe u punësua në Institutin e Mjekësisë Popullore.

Demë Ali Pozhari, edhe pse jetoj edhe 6 vjetë, pasi e përcollti djalin, ai vdiq me pengun e madh, për ta parë Ibrahimin e tij. Qeveria Shqiptare as nuk i dha vizë-hyrëse atij dhe as nuk lejoi kthimin e Ibrahimit në Turqi, edhe pse një anije tregtare, me 12 dhoma për pasagjerë, lundronte, të paktën, tre herë në muaj për në Stanboll! Për çudë, edhe familjet, me lidhje gjaku, ku çmallej e ngushëllohej djali Ibrahim, u goditën u burgosën.

Pas 23 vjetësh, në vitin 1993, në shoqërim të Ministrit të Informacionit të Republikës të Kosovës, Xhafer Shatrit, trokita në derën e banesës të Ibrahim Pozharit, ke 9-të Katshet e Tiranës, tashmë, me nuse dhe dy djemtë: Demën dhe Ermalin.

Demë Ali Pozhari është vlerësuar nga Presidenti i Shqipërisë, me titullin e lartë - Nderi i Kombit - dhe nga Presidentja e Kosovës me - Urdhëri i Lirisë-, për veprimtari atdhetare e luftarake, për mbrojtjen dhe lirinë e Kosovës.

**Ndue Sanaj, Prele Milani
e Kolë Çardaku**

Ishin atdhetar e luftëtar për bashkimin e trojeve shqiptare, pavarësisht bindjeve ideologjike

Fjala përshëndetëse, me rastin e manifestimit përkujtimor për nderimin e Demë Ali Pozharit dhe Tribunëve të Kombit



Të nderuar të pranishëm!
I nderuar zoti Ramush Harajdinaj!
I nderuar zoti Bashkim Ramosaj, Kryetari i Komunës Deçan!
I nderuar zoti Ukshin Jashari, Kryetari i Shoqatës "Martin Dreshaj"!
I nderuar zoti Frashër Racaj, Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar!

Të nderuar familjare, të familjes së Demë Ali Pozharit, Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Dreshaj!

Zonja e zotërinj!

Kënaqësi e veçante të bashkëpunosh me ju të nderuar dhe në veçanti me Shoqatën e vëllezërishë Kosovë-Malësi e Madhe, e pagëzuar me emrin "Martin Dreshaj", se sa here bashkohemi e zhvillojmë veprimtari të përbashkëta, aq here na duket vetja më shqiptar të një gjaku, të një gjuhe e të një tradite dhe aq më shumë e kemi futur njeri-tjetrin në punë të përbashkëta që i shërbejnë kombit! Dhe në këtë rast, shqiptareshe jemi duke nderuar veten, se duke nderuar kontributin e atdhetareve Demë Ali Pozharit, Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Dreshaj, se këta heroit u flijuan për një diçka të madhe, për kombin shqiptar, që ai të ishte i bashkuar dhe faktor stabilizues në gadishullin Ilirik!

Në këtë manifestim, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ka ngarkuar një grup të përbërë nga N/kryetari i saj, studiuesin e historisë, poetin, botuesin e publicistin Prele Milani; anëtarin kryesisht, mësuesin në pension Kole Çardaku, dhe Juli Kosteri, për të marrë pjesë në këtë manifestim.

Në emër të grupit, mirë se ju gjetëm!

Të flasim për jetën e veprën e këtyre katër burrave të Kombit Shqiptar, duhet një simpozium i veçantë dhe nuk e di nëse do ja arrinim qëllimit, për të paraqitur para jush gjithë kontributin e tyre për çështjen e kombit tonë. Por në këtë takim, nga

kjo tribune e nderuar e para jush, dua të ndalem në një moment të jetës së Demë Ali Pozharit, të shkruar nga Idriz Zeqiraj, te gazeta "Bota Sot", me titull "Demë Ali Pozhari i pari i nacionalistëve të Dukagjinit", me 23 mars 2018: "Hotel "Dajti", Tiranë, nëntor 1969, e takova Demë Ali Pozharin. Edhe pse i moshuar, shtatlartë, me tipare të krenarisë dhe të bukurisë burrërore, rrezatonte kthjelltësi mendore dhe energji trupore. Me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, ishin futur bashkatdhetar nga Mërgata, kryesisht, të moshuar, pjesa më e madhe mërgimtarë ekonomikë, të larguar para Luftës së Dytë Botërore, por, edhe ndoshta politikë, nga trojet shqiptare jashtë Shqipërisë londineze. Në mesin e tyre ishte edhe Demë Ali Pozhari, që llogaritet si kryenacionalisti i Rrafshit të Dukagjinit, udhëheqës i rezistencës, në mbrojtje të territorit tokësor, në Rrafshin e Dukagjinit dhe të Sanxhakut, përfshi edhe Plavë e Guci. ...

Për festën e çlirimit, Bije Vokshi arriti më parë në Tiranë dhe u vendos në Hotel "Dajti". Ishim kureshtarë për takimin e parë, që do të kishin, pas një çerek shekul-

li, me Demë Ali Pozharin, si kundërshtar politik me armë. Ja, biseda e parë, në mes kundërshtarëve politikë të dikurshëm:

- Bije Vokshi: "Demë Ali Pozhari, po të kisha nxënë para 25 vjetëve, do ta zgjidhja lisin më të gjatë për me të varë". Dhe, me kaq u bë pajtimi i dy kundërshtarëve politikë të luftës, që përfaqësonin dy rryma armike me njëra-tjetrën".

Në muajin shtator 2006 isha për here të parë në Gjakovë. Isha i interesuar të di diçka më shumë, për një vajzë nga Shkodra, fshati Palaj të krahinës së Shllakut, e cila ishte arrestuar nga UDB-ja serbe dhe ishte pushkatuar në vitin 1946.

Te lapidari i UÇK-së, në një stol ishte një burrë i vjetër, me kësulë në krye. I afrohem dhe i marre leje për tu ulur. Ulem dhe filluam të bisedojmë:

-Si jeni Bacë?

- Mirë jam, ma ktheu.

-Nga jeni?, - më tha ai

-Jam nga Shkodra, i thashë.

Më tha, - shqiptar shqipinie?

Jo i thashë, - jam shqiptar prej Shkodre, siç jeni ju Shqiptar prej Gjakove!

Çka keni punue?,- më pyeti?

-Kam qene oficer, i thashë.

-Më tha, oficer i Enver Hoxhës?

Jo, i thashë, - oficer i ushtrisë shqiptare

...
-Më tha, ah çka dreqi kenke ..., por dua me të thane, se komunistët ishin tradhtar..

- Pse, ishin tradhtar? , e pyes unë.

- Komunistët na paditshin, më tha ai.

- I them, po ata shqiptar, që paditshin komunistët te pushtuesi, me çfarë emri t'i pagëzojmë?

- Ah, kenke vërtetë dreqi vete, më tha ... dhe kështu vijua disa minuta.

- Pastaj, i thashë, më fal që të shqetësova, por dua të di diçka më shumë, për Marie Shllakun, se jam i interesuar për jetën e saj.

Muhameti, kështu e quanin atë, po sa i përmenda emrin e Maries, menjëherë u ngrit në këmbë gjithë ai burrë, që ishte dhe një pëllëmbë më i gjatë se unë, mu drejtua me gisht: Po të tregoj unë, se kush ishte e madhja Marie Shllaku: "Na kurrë nuk jemi përqafua me motrat tona, por me Marie Shllakun sa here takoheshim, se ishte e madhe, e jashtëzakonshme, fjalë nuk i binte në tokë dhe ne e vinim në vend të parë për të biseduar me te, si i barabarte, por jo pak raste mbesnim në klasë, se ishte shumë e zgjuar, shumë e ditur dhe e palodhur.

I cilësova këto dy momente, për të treguar, se pavarësisht bindjeve politike apo ideologjike të katër këta burra dhe të tjerë, se ata nuk ishin vetëm, si Marie Shllaku, Ndue Perllëshi, At' Shtjefen Gjeçovi e të tjerë e të tjerë, ishin atdhetar e luftëtar për trojet shqiptare, për bashkimin kombëtar, që nen shembullin e tyre duhet të ecet dhe sot, me mendësitë e kohës dhe pozicionin që kanë shqiptarët në gadishullin Ilirik.

Sot, jemi në një pozicion tjetër! Shqiptarët kurrë nuk kanë qene në pozita më të favorshme politike se sa sot, por kjo situatë nuk mund të shfrytëzohet për të ecur më tej me mendësi të së kaluarës. Dhe në këtë tubim, nuk kemi të gjithë

të njëjtën mendësi politike e ideologjike, por kemi një emërues të përbashkët, kemi kombin shqiptar, i cili duhet bashkuar. Por ne, duhet të punojmë të bashkohemi pjesë-pjesë, se bashkimi i plotë menjëherë, mendoj se është e pamundur. Në këtë bashkim del në plan të parë bashkimi i Republikës Dardane me Republikën e Shqipërisë.

Lavdi jetës e veprës së këtyre tribunëve!

I përjetësohem qoftë kujtimi i këtyre tribunëve!

Faleminderit për vëmendjen që më kushtuat!

Ndue Sanaj,

Deçan, me 18 dhjetor 2021



LULEBORË PLOT AROMË

U zhvillua me sukses veprimtaria e gjashtë i Festivalit “Luleborë”

Ëmbël tingëllon emri luleborë në bisedat e shkodranëve sa herë bie rasti ta lakojnë si kryefjalë të diskutimit, por akoma më këndshëm dhe më me kuptim bëhet ajo kur zëmë të diskutojmë për festivalin “Luleborë” që mbart emrin e kësaj luleje plot hijeshi, të pagëzuar si mbretëresha e luleve në oborret shkodrane.

Prej vitesh ky festival sa vjen e bëhet më i dashur dhe i adhuruar për artëdashësit shkodranë e jo vetëm, të cilët nuk e shohin thjeshtë si argëtim, por e përjetojnë me emocione të forta çdo prurje të re, e cila si askund tjetër, kritikun dhe spektatorin i ka një, i ka në sallë dhe bën të mundur nxitjen dhe inkurajimin për përsosmërin e tyre dhe ruajtjen e kritereve të trashëgimit të këngës së bukur qytetare.

U bë një kohë e gjatë që kjo krijimtari nuk e pai fatin t’i dhurohej spektatorëve të mrekullueshëm në sallën e Teatrit “Migjeni”, këto këngë të bukura, ashtu siç Shkodra di t’i dhurojë, ashtu si sportistët në fushë nuk shijuan ovacionet e spektatorëve, ashtu si një çift i martuar nuk e përjetoj shpërthimin e dasmorëve në dasëm, ashtu si një nxënës në klasë për disa muaj nuk i përjetoj çapënkllëqet me shokët e klasës së tij, për shkak të pandemisë që paralizoi edhe jetën sociale dhe kulturore të vendit tonë.

Për të gjitha këto ndoshta sot unë jam më i lumtur që në shkrimin tim të rikthej një koncert live, një aksion me personazhe, artistë të mrekullueshëm, që sfidojnë çdo anë të errët që ka tentuar të gjunjëzojë njerëzimin.

Në Teatrin “Migjeni” përfundoi me sukses edicioni i gjashtë i Festivalit të Këngës Qytetare “Luleborë”, një organizim i madh kulturor, i cili nuk është më një projekt, por eveniment, një realitet i mundur nga Bashkia Shkodër dhe Teatri “Migjeni” me ekipin realizues, pasi pas rreth 30 viteve, 6 vjetë më parë u rikthye në jetën artistike të qytetit, por jo vetëm kaq, por edhe në atë sociale, pasi qyteti i Shkodrës nuk ndjehet mirë kur në teatrin e tij mungojnë shfaqjet, koncertet e festivalet, kur në stadiumin e tij dhe në pallatin e sportit mungojnë vajzat dhe djemtë sportistë, nuk ndjehet mirë kur në bibliotekën e qytetit mungojnë promovimet e shkrimtarëve dhe poetëve të rinj.

Publiku shkodran për dy net me radhë ndoqi performancën e këngëtarëve të mrekullueshëm, që interpretuan 16 këngë të reja të autorëve të njohur e të ri, duke u suprizuar nga rikthimi në skenë pas shumë vitesh i artistes së madhe Justina Aliaj, e cila plot energji dhe freski performoi në skenën e këtij festivali, duke merituar duartrokitjet e publikut.

Çdo vit po kthehen në folenë e tyre, në Shkodren e luleborës e karajfilave, për ngjarje të rëndësishme artistike, siç është Festivali “Lulebore”, emra të mëdhenj të këtij qyteti. Sivjet ishte surpriza e kësaj pjesmarrje, Justina Aliaj. E kush nuk e njihet artisten e madhe të skenës, shpirtin e lirë që si në këngë dhe në aktrim ka

shkëlqyer përherë. Shkodra di të rrezatojë edhe në kohë të veshitura! Rikthimin e saj në skenë ajo e përjetoj me plot emocione në këtë festival.

Shkodra ka një traditë të mrekullueshme të kulturës dhe të muzikës. Konsiderohet si qytet muzikantësh dhe është shumë normale që të bësh një festival, jo vetëm si ky, por edhe festivale të tjera

Radios në Tiranë në vitin 1962, kur kompozitori i madh Prenk Jakova ishte në kulmet e tij artistike dhe shoqërohej nga një orkestër që përbëhej nga 15 instrumentist që u prit shumë mirë nga publiku.

“Lulebora” sot shoqërohet nga një orkestër që përbëhet nga 20 instrumentist të mrekullueshëm, vazhdues të denjë të paraardhësve të vet.

me moderatorët e mrekullueshëm plot sharm dhe elegancë Enkel Demi-gazetar e shkrimtar, Rosela Gjylbegu-këngëtare, si dhe hijeshija e fina e skenografisë së Divni Gushtës, arritën të krijojnë kurorën e “Luleborës”.

Këngëtarë pjesëmarrës në këtë festivalit ishin: Justina Aliaj, Artan Bakia, Klodiana Brahimi, Rezarta Smaja, Orjeta



duhet të ketë, pasi kjo është një specifikë që i dedikohet një krijimi, pra të ketë edhe formate të tjera ashtu siç është emblemë e këngës shqiptare, “Lulebora” që ka pushuar zemrat dhe është e freskët.

Djepi i artit dhe i kulturës, vazhdon të përkundet, sepse këtë djep e përkund me këngën e saj një nënë që nuk i vë rëndësi paraqitjes së saj, por dashurisë që ka për atë që përkund. Kjo është Shkodra, e cila kështu ka qenë dhe do të jetë.

Në këtë festival u ngjiten në skenë këngëtarë të rinj shumë të talentuar dhe këngëtarë të afirmuar. Nga Kosova zgjodhi të bëhej pjesë edhe kantautori Artan Bakia, i cili vlersoj realizimin e këtij festivali dhe vlerat muzikore që ai përcjell.

Skena kishte një pamje pranvere të shkëlqyer që përkëdhelte Luleboren dhe aroma e saj kishte përfshirë gjithë qytetin. Një skenë plot me lule ku lulëzuan edhe zërat e bukur të qyteti të Shkodrës si në një festë të vërtetë.

Festivalin e hapi këngëtarja simpatike dhe e talentuar Klodina Vata me këngën “Tatuazhi”, teksti nga Ramazan Çeka, muzika Artion Qamili, orkestruar nga Markelian Kapidani.

Festivali “Luleborë” në konceptin e Festivalit të muzikës së lehtë e ka fillësën disa muaj para fillimit të Festivalit të

Puna me aq profesionalizëm e mjeshtrave Shpëtim Saraçi dhe Markelian Kapidani si udhëheqës artistik ishte qershia mbi tortë, punë që veç ato dinë ta bëjnë kaq mirë. Ajo që vlen të theksohet është se këtë orkestër virtuozë e drejtonte djali i një virtuozit të humorit shqiptar, djali i humoristit të shquar, Zef Deda “Mjeshtër i Madh”, pra ishte Mario Deda ai që me shumë përkushtim përcollti këngët në mënyrë profesionale dhe bashkëkohore dhe ishte një nga pikat e forta të festivalit.

Pjesa më e ndritshme e këtij festivali përveç krijimeve dhe interpretimeve të shkëlqyera nga zërat brilant të këngëtarëve, ishte edhe orkestra shumë e përgatitur dhe stafi teknik ku secili është më artist se tjetri.

Ishte një trupë ku çdo pjesë kishte rolin e vet, pjesë që shihen dhe që nuk shihen, pjesë e rëndësishme e cilësisë së një shfaqjeje, duke filluar me platformen muzikore e kujdesin për te, duke vazhduar me ndjesinë vizuale artistike të skenës, për të cilën duhet falenderuar drejtoresha e Teatrit “Migjeni” Rita Gjeka “Mjeshtre e Madhe” si regjisore, e cila arriti të mishërojë të gjithë komponentët artistikë, skenaristja Ermira Alia dhe libreti i përgatitur me nivel të lartë artistik dhe me profesionalizëm, së bashku

Kelaj, Blerta Cina, Klodiana Vata, Glerdit Turmetaj, Elsidë Sinaj, Saviana Vjerdha, Ademir Fresku, Xhuli Pjetraj, Laorjan Ejlli, Marjana Serreqi, Ylber Tahiri, Jozefina Simoni, Ana Bushgjoka, dhe Leticia Gargjola.

Melodia e këtij festivali ishin kompozitorët: Edmond Zhulali, Florent Boshnjaku, Aleksandër Jakova, Ilir Zoga, Enis Mullaj, Namik Jahja, Roland Guli, Bardhyl Hysa, Artion Qamili, Orges Toçe, Alban Krajin dhe Almarin Zadeja.

Një krijimtari brilante sollën edhe poetët: Jorga Papingji, Alfred Çapaliku, Pandi Laço, Ramazan Çeka, Meri Guli, Arjola Zadrima, Nesti Gjoni dhe Erjona Rushiti.

Një larmi dhe ritëm i dhanë këtij festivali edhe dirigjentët e mrekullueshëm: Jetmir Barbullushi, Ilir Zoga dhe Griti Kraja.

Që nga fillimi i kësaj veprimtarie e deri në edicionin e këtij viti është iniciuar, mbajtur dhe fuqizuar në sajë të dy grave të forta e të palodhura që janë Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi dhe drejtoresha e Teatrit “Migjeni” znj. Rita Gjeka, të cilat me dëshirën e madhe po e çojnë Shkodrën drejt një vizioni kulturor, që kapërcen institucionalisht kufijtë lokal.

FESTIVALI BURIMOR “TREVA 2022”

“Urojmë, dhe gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen
“GËZUAR FESTAT E FUNDVITIT!”

Me datën 12 dhjetor 2021, ditë e Diele, për dy orë rresht, Teatri “Migjeni”, ushtoi nga këngët folklorike, tashme të njohur, nga ansambli burimor “Treva”, me një pjesëmarrje plotë e përplot me dashamir të folklorit dukagjinas.

Filloi hapja e koncertit, me këngën “Jena Dukagjinte e Lekes”, me një pamje të veçantë rreth trevezës, që në qendër të saj ishin lahutarët dhe në te dy anët, në këmbë grupi i burrave që këndojnë, dhe valltaret që vijnë duke shoqëruar me këngën, dhe të gjithë këta janë në sfond të një peizazhi fantastik të maleve të Dukagjinit.

Me përfundimin e kësaj kënge, moderatorja e njohur, Kozeta Bruçi, në emër të këtij Ansambli, tha: “Urojmë, Ju në veçanti, dhe gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen “GËZUAR FESTAT E FUNDVITIT!”

Grupi muzikor “Treva” erdhi në këtë koncert për të 19-tën here, me këngët, meloditë dhe vallet e reja, më të bukurat e vitit, duke e kthyer festivalin burimor në një manifestim kulturor, duke sjellë të vjetrën tonë të re në varg, melodi, veshje dhe interpretime, që për pjesëmarrësit mbeti një kujtesë e bukur e këtij viti.

Kënga “Jemi Dukagjintë e Lekës”, ishte me ide te Gjelosh Bicaj, tekst e muzike nga Fran Kodra, u këndua nga grupi i burrave dhe qe na çonte në gjurmë shumë e vjetër në besëlidhjen e dukagjinëve.

Koncerti vijon me lahutën “Lahuta jonë shqiptare, bashkudhëtarja jonë në breza, që përcolli lavdinë e heronjve, testamentin e historisë sonë, të Dukagjinit e Malësisë. Certifikimi i saj në UNESCO po bëhet padrejtësisht nga shteti fqinjë. Por lahuta e vjetër ilirjane do te jehojë dhe këndoj gjithmonë shqip. Historia na rrëfen shumë luftëra me gjakderdhje dhe

me flakë dhe që shpesh kjo flakë e ka djegur edhe historinë, por jo kurrë këngën e Lahutës e çiftelisë. Ato nëpërmjet gojëdhënës, kanë përcjellë saktë, kohe mbas kohe, trimnitë dhe amanetet e brezave. Të frymëzuar nga këto ngjarje, që janë përcjellë në braza nëpërmjet Lahutës,

Me një zë shumë të ëmbël doli në skenë Gjelosh Hajdari, nga Pecajt e Shalës, ardhur enkas nga mërgimi me këngën episodike të Dukagjinit, - “JAM MALSOR”!

Një variant shumë i vjetër i këngëve të malit “Moj e mirë si shkon me gja” u interpretua me mjaft talent, në një mënyrë



vëllezërit Ndue e Agim Shytani, që Agimi erdhi enkas në këtë koncert me një baladë lahute. “Moj lahut ti je e jona / Je rritë n’prehen t’beshkve tona / Kombit tonë s’ke me u nda kurrë / Pa u nda shqipja me flamur/ ...”

Më të rinjtë e këtij grupi, të “Trevës”, Gentjan Gropaj nga Thethi e Bledar Hysaj nga Nikajt, të cilët dolën për here të pare në skenë, erdhën me këngën “E kan than zanat e malit”: “E ka shkru rruga e shtegtarit / Ka jehue kanga e kushtrimit / S’ka si treveza e Dukagjinit / ...

shumë fisnike e të bukur, nga këngëtarja e mirënjohur tashme Viola Shqau dhe Sokol Gjoni

Me një tekst krejt te veçantë për Mehmet Shpendin doli në skenë këngëtarja i mirënjohur Kolë Hasani-Martini. Ja disa vargje: Në qafë të Agrit kur ka dalë / Mehmet Shpendi flet një fjalë / Turgut pash mos ec ma knena / Kam me vedi 3000 zemra / 3000 zemra prej florinit / 3000 burra të Dukagjinit/ Mos guxo me i prek kto troje / Bajme Stamollin hap e vorre.

thotë këtij burri

Me një interpretim mjaft kuptimplote vjen këngëtarja Zef Marku nga Boksi, me një këngë për vajzat e emigrimit, që kujtojnë djali në vendin e lindjes

I vjen momenti mjaft i pritshëm i humorit te njohur, Gegë Shpati. Ja disa vargje te këtij humorit, me titull “AMAN DORA E PERËNDISË”: “Aman dora e Perëndisë/ L’shoja një sy historisë/ Hiqi pak gjyslyktë prej ballit / Mendo pak për fat t’shqiptarit / Një mijë herë t’u kena lutë / Nuk po rrin kush pa na futë / Dorën

Me shumë nostalgji u përkujtua muzikanti, trompisti Sokol Marku dhe mjeshtri i madh i dirigjimit Kujtim Alia dhe nën bekimin e tyre festivali vazhdoi me këngën “Andrra e jetës” me tekst të Ndre Mjedës e kompozuar dhe orkesruar nga vetë kantautori nga Kosova Artan Bakia, i cili është edhe kryeredaktor i Radio Dukagjinit.

Në këtë festival mori pjesë edhe një nga kompozitorët më të shquar të muzikës shqiptare, maestro Florent Boshnjaku, i cili këtë vit pasuroi Festivalin “Luleborë” duke na dhuruar një perlë nga ato më të përkryerat që vetëm ai di të bëjë kaq bukur. Ai erdhi në këtë festival me kompozimin dhe orkestrimin e këngës “Si në andërr”.

Vlen të theksohet se në këtë edicion të këtij festivali është shtuar edhe një detaj i rëndësishëm. Të gjitha këngët konkurruese janë hedhur në një platformë dixhitale, siç është You Tube, për t’u dëgjuar dhe perceptuar më mirë nga publiku.

Pjesë e këtij festivali ishin edhe aktorët Fritz Selmani, Jozef Shiroka dhe Kristi Lleshi, të cilët me interpretimin e tyre dhuruan emocione të forta për spektato-

rin.

Në këtë festival u interpretuan edhe dy këngë të kompozitorit të madh Simon Gjoni të lëna në dorëshkrim të pakënduara më parë, që ruajnë akoma aromen e Shkodrës dhe freskinë e kohës. Autorët e teksteve janë: Aleksandër Banushi dhe Zef Leka, me titull “Moj syshkrume” dhe “Pash dy sytë e tu si drita”, të orkestruara në një kolazh nga mjeshtri Shpëtim Saraçi dhe Markelian Kapidani dhe që i këndoi Rosela Gjylbegu.

Kurorëzimi i edicionit të gjashtë të Festivalit “Luleborë” tregoi edhe një herë tjetër vlerat artistike të qytetit të Shkodrës, e cila ruan traditën e saj të bukur dhe ia përcjellë brezit të ri.

Ishin 16 këngë të reja në këtë festival të përzgjedhura nga 34 kompozime, gjeografia e të cilave është rritur dhe për vlerësimin e tyre ishte ngritur një juri që përbëhej nga: Maestro Zhani Ciko-kryetar, Osman Mula-kompozitor dhe regjisor, Kozeta Kurti-gazetare, Gjon Shllaku-kompozitor dhe dirigjent, si dhe artisti Andis Gjoni, djali i kompozitorit Simon Gjoni, koreograf i njohur në Amerikë, i cili dhuroi një çmim të veçantë për Fes-

tivalin “Luleborë”, një gjest dashurie dhe respekti, si dhe një motiv më shumë për këtë festival.

Juria e Festivalit e kryesuar nga maestro Zhani Ciko vendosi të nderoi me çmimin e karrierës këngëtarën e shquar Justina Aliaj, me këngën “Ty me t’kujtu” me tekst të Pandi Laços dhe muzikë të Aleksandër Jakovës.

Rezarta Smaja me këngën “Si në andërr”, një komozim dhe orkestrim i maestro Florent Boshnjakut, me tekst të Artila Zadrimës u shpall fituese e çmimit të parë e Festivalit “Luleborë” në Shkodër.

Me çmim të dytë u vlerësua dueti Saviana Vjerdha dhe Ademir Fresku me këngën “Sa bukur” me tekst dhe muzikë të maestro Mario Dedës.

Ndërsa me çmimin e tretë u vlerësua këngëtarja Jozefina Simoni me këngën “Pa adresë” me tekst dhe muzikë nga Orges Toçe, orkestrimi: Markelian Kapidani.

Çmimin e veçantë “Simon Gjoni” si interpretuesi më i mirë e fitoi këngëtarja Laorjan Ejlli me këngën “Mall” me tekst të Jorgo Papingjit dhe muzikë të Almarin Zadejës, orkestruar nga Endri Sina.

n'zemër kurrë s'e vune / Si u ndamë në pese flamurë. ..."

I vjen radha këngës së bute "S'ka si çika e Dukagjinit", i kënduar nga Ndue Shytani, Fran Kodra, Viola Shqau e Aurela Musheqaj si dhe grupi.

Nga emigracioni vjen Kryetar i Shoqatës "Ura e Bashkimit" në Milano-Itali, me fondet e së cilës janë ndihmuar shumë familje në nevojë në zonën e Malësisë së Madhe. Ai është njëkohësisht edhe aktivist i Grupit "Treva" dhe këngëtar i talentuar, me një lirikë për dashninë e vjetër Petrit Gjinaj.

Këngëtar i rapsodi i mirënjohur dukagjinasi e më gjerë, Gjovalin Shani doli në këtë skenë me këngën "Kupe Danjen", në thelb së cilës është: "Shkodra legjendare me tri besime, por me një identitet si shkodran e si shqiptare, nuk i ka të pakta heroizmat. E njeri prej tyre ishte dhe ai i Kupe Danjes, që mbrojti femrën e besimit katolik nga përdhunimi i ushtarit osman, me jetën e tij".

Me një baladë shumë të bukur kurbetiv "O moj dera e shtëpisë" vjen në këtë koncert nga Norvegjia,

Agim Shytani

Kristian Zalli, vjen enkas nga Italia, me një këngë krejt të re dhe me një përmbajtje nostalgjike, me titull "Si po harrojmë kret" dhe ja disa vargje: "Dikur në kasolle, Kena vujt me vjet / Sot i kem me kate, po i kem lan shkret / E kem kja me lot, buk mikut me i dhanë / Sot asht treveza plot, po s'ka kush me ngranë / ..."

Në kete koncert nuk mund të mos ishin pezant me humorin e tyre brilant, "Grupi gaz e maraz", i përberë me dyshen e veçantë, artistet e vërtetë nga Malësia e Madhe, Gac Kodrina e Qazim Çela, të cilët me humorin e tyre të goditur, çuan peshe pjesëmarrësit në salle.

Fran Kodra e Ndue Shytani, këndojnë një baladë, me titull: "JETË moj JETË", kushtuar te pavdekshmit kantautorit Mhill Çuni Gjonaj. Objekti i tekstit është: "Jeta dhe vdekja, dy beteja të padrejta, ku gjithmonë fiton e fundit. Të vetmit që fitojnë mbi vdekjen janë këngëtarët. Zëri i tyre nuk vdes kurrë. Folklori i Dukagjinit kishte një emër të madh, që fizikisht nuk jeton sot. Është rast i rrallë në art, që një artist si Mhill Çuni, të jetë një za i fuqishëm, një muzikant i talentuar si dhe një poet i lindur. Këngët e tij nuk do të vdesin kurrë". Dhe ja disa vargje: "Sa t'jen malet shkam e gurë / Lumi i Shalës për nan urë

Sa t'këndojn bilbilat n'bjeshkë / Dukagjini si t'ka deshtë / Emni yt ska me vdekë kurrë"

Në skenë del kantautori Prekë Mrishaj, i cili nuk mund të mungonte duke ardhur me këngën lapidar "Shqipet tona s'kërkojnë tjetër / Veç ka i kem kufijtë e vjetër"

Këngëtar i Bardhok Luca, doli në skenë me një këngë që i kushtohet historia së lashtë, që në mes të tjerave është e lidhur fort me Pultin e largët e krenar dhe i shquar për mënyrën se si u organizua.

Këngëtar i Leonard Pjetri, nga Puka, përshëndetë enkas me një këngë patriotike pjesëmarrësit.

Këngëtar i mirënjohur nga Nikaj-Merturi, Zef Beka vjen enkas në këtë koncert me një potpuri të bukur lirike.

I vjen momenti me dale në skenë "TRIO-liriko-gazmore", këngëtarja e



mirënjohur Elvira Fjerza nga Malësia e Madh te shoqëruar nga këngëtarët Fran Kodra e Ndue Shytani. Ja disa vargje: "Ku vajza thot për djemtë / Boll bukur knojn gjelat... / po veztë i ban pula ..."

Në mbyllje nga grupi përsëritet kënga: "JEMI DUKAGJINTË E LEKËS", me valltarët.

Për realizmin e këtij koncerti u falënderua: Bashkia Shkodër, grupi e Teatrit

"Migjeni, 20 këngëtarët pjesëmarrës, Valltaret e Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci", me koregraf Aldo Nika, Drejtuesin muzikor-Luan Dagistani, udhëheqësin organizativ- Ndue Shytani, udhëheqës artistik- Fran Kodra, studio "Valbona" për filmimin e festivalit

Grupit të ansambilit "Treva" e Dukagjinit i shprehim mirënjohjen e thellë, për punën që bëjnë dhe me shumë e sakrificë. Ju lumtë! Por, sugjerojmë të keni shumë kujdes me përmbajtjen e këngëve, tekstet e tyre. Mendojmë, asnjë tekst, që i bën jehonë strukturave të pushtuesit Osman, i cili për rreth 4 shekuj, me dekret të veçantë nuk na la të mëkojmë e shkrijmë gjuhen e Nënës Shqipe, as një tekst që është me fjalor turk dhe me gabime historike, nuk duhet lejuat të jete pjese e koncertit tuaj.

Ndue Sanaj, Kozeta Bruçi



Mirënjohje “pa kufi” për albanologun kanadez të ndjerin prof. Robert Elsie



Filip Guraziu

Megjithëse e kam ndjekë “prej larg”, dashunia për “botën” shqiptare e kanadezit me origjinë gjermane, Robert Elsie e shprehun botnisht nëpërmjet veprave të shumta albanologjike me ka krijue vazhdimisht jo vetem emocione, por edhe respekt të veçantë.

Përkushtimi intensiv intelektual i këtij eruditi për vlerat e “shqiptarizmit”, përban një rast unikal të pandigjuem në historinë e studjuesve të kulturës shqiptare dhe të pakrahasueshëm në vlerë, cilësi e sasi me çdo albanolog shqiptar ose të huej të maparshëm.

Robert Elsie leu në Vancouver (Kanada) me 29 Qershor 1950. Arsimin e mesëm e kreu në Vancouver, kurse studimet në shkollën e naltë për filologji klasike dhe gjuhësi i përfundoi në vjetin 1972 pranë “British Columbia University”. Rezultatet e nalta në provimet universitare i mundësuen bursë studimi në universitetet ma prestigjoze të Europës. Në vjetin 1978 mbrojti doktoraturën në Universitetin e Bonn-it (Universität Bonn).

Prej këtij vjeti e mbrapa iu krijue mundësia me vizitue Shqipninë në kuadrin e “takimeve shkencore” midis Institutit së Gjuhësisë së Universitetit të Bonn-it dhe Akademisë së Shkencave të Shqipnisë dhe po ashtu për disa vjetë me radhë mori pjesë në Seminarin Ndërkombtar për Gjuhën, Letersinë e Kulturën Shqiptare në Kosovë ku mësoi gegnishten.

Këto udhëtime që vazhduen deri në fillimin e vjetëve 80-të i ngjallën një interes të veçantë për Shqipninë e mbyllun dhe për kulturën e saj të panjohun në botë. Mbasi mësoi shqip dhe i thelloi njohunitë e tij në këtë gjuhë, Robert Elsie vendosi me iu kushtue albanologjisë, fushë në të cilën ai ma vonë do të bahej një ndër ekspertët ma të njohun. Elsie asht sot autor i ma shumë se gjashtëdhjetë librave dhe artikujve të panumërt, kryesisht në fushën e albanologjisë (Gjuhësi, letersi, kritikë, histori, fonetikë, folklor, përkthime, artit

fotografik etj.) Falë veprave e përkthimeve ne gjuhën angleze e gjermane, vlerat e kulturës dhe të vertetat e problematikave shqiptare “ fituen za” në botë. (“ Lahuta e Malsis – At Gjergj Fishta” u përkthye në anglisht; poezitë e Migjenit në gjermanishtetj etj.; veprat mbi Çamërinë e Kosovën i kujtuen botës gjenocidet kriminale të paharrueshme të grekëve e të serbëve mbi popullin shqiptar etj.)

Mbas studimeve universitare ai punoi për Ministrinë e Jashtme Gjermane në Bonn dhe prej vjetit 2002 deri 2014 për Tribunalin e Hagës si përkthyes edhe në gjykimin e Sllobodan Millosheviçit.

Robert Elsie asht anëtar i Shoqatës së Europës Juglindore (Südosteuropa – Gesellschaft), Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe Anëtar Nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Gjithashtu Robert Elsie asht dekorue prej

fluturimin e tyne, botës i japin vlerë...”. Po, Robert Elsie ishte i tillë, ai ishte skyfiter i naltësive, por..., ishte edhe ma tepër se aq: ishte “shqipja e naltësive të vlerave shqiptare”.

Kjo “shqipe” fluturoi e vrojtoi pothuaj të tanë boten, prej Vancouver-it në Kanada, Sh.B.A., Europë, Gjermani, Itali, Francë, Angli, Ballkan etj., e prej naltësive me synin e sajë të mpreftë vlerësoi malet shqiptare, ku u ndal dhe nuk u largue ma...! Shqipja u dashurue me tokën e shqipeve! Ajo “shqipe” e ardhun prej Vancouver-it u ba bijë e kësaj toke prej të cilës nuk u nda kurrë ma, por qendroi e perqafueme në përjetësi...! Ai sot fizikisht nuk asht ma në mes nesh. Ne nuk mundemi t’a përjetojmë buzëqeshjen e tij të pafajshme e as t’a ndigjojmë zanin e tij melodioz ndërsa argumentonte me sy kritik, por me dashamirësi, problematikat


pikërisht sepse janë të thjeshtë!

Kështu ishte edhe i ndjeri Robert Elsie. Z. Trierweiler ia zbatoi dëshirën e tij, vorri modest në Theth ku prehet Robert Elsie provon sa ma nalt.

Por, në mbrendsinë time ndij se vepra e këtij kolosi, qëndrimi i tij fisnik, e thjeshtësia e tij na detyrojnë moralisht drejt një mirënjohje përherë e ma të madhe... Ndoshta kishte me qenë dinjitoze, nderim e mirënjohje për të ndjerin Robert Elsie zbatimi i një mikroprojekti në vendin ku pushon Roberti, në Theth që nënkupton:

a. Mbulimin me xham në forme piramide të vorrit modesit me gurë (tue e lanë të paprekun në origjinalitetin e tij)

b. Nderimin e një shtëpije karakteristike thethiane një katëshe (në zonën rrethuese jo larg vorrit), 1m. të ngritur prej terrenit me s’paku dy dhoma; njana



Presidentit të Shqipnisë z. Bujar Nishani me “ Medaljen e Mirënjohjes”.

Për shkaqe natyrore u nda prej kësaj jete në paraditen e së hanës me 2 Tetor 2017 në qytetin e Bonn-it Gjermani, me dëshirën për prehjen e tij të përjetëshme në dheun Shqiptar, gja që e dëshmoi dhe e realizoi shoku i tij i jetës, Stephan Trierweiler në Theth të Dukagjinit ku u varros me nderime në datën 18 Tetor 2017.

Para disa vjetëve kam pasë shkruar: “...jetojnë në histori, ato skyfiterë, që me

shqiptare... Për njerëzit e zakonshëm jeta ka një fund, por për Robertin, ”shqipen e naltësive, që me fluturimin e sajë, botës shqiptare i dha vlerë” nuk ka fund, ka vetem përjetësi. Janë veprat e Robert Elsie që jetojnë me ne dhe me brezat që do të vijnë.

E verteta asht se shqiptarët andej e këndej kufinit politik e patën nderue dhe u patën tregue mirenjohës për Robertin, por “Mirënjohja” a ka kufi?

Njerëzit e Mëdhaj, janë të Mëdhaj,

dhomë si muze në kujtim e nderim për të ndjerin Robert Elsie e tjetra sallë takimesh me s’paku 40 karrige.

c. Vendosjen e bustit të albanologut të madh në një pozicion të përshtatshëm para hymjes në muze.

Ju kujtoj të nderuem lexues, se kujtimi e nderimi i albanologut te madh Robert Elsie (si ma nalt) përban edhe një “vlerë shtesë” shumë të randësishme për aktivitetin turistik të Thethit në shërbim të banorve të tij.

Pathyeshmëria dhe madhështia e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

Një përkthim i vyer nga suedishtja në shqip i të mirënjohurit Sokol Demaku



Viron KONA

“Këtu pushon Kastrioti, ai, SKËNDERBEU! Sa i shkathët ishte ai! Sa i drejtë ishte ai!... Çfarë modeli për mbretërit!”

Zannovich Stephan

Sokol Demaku, poet, shkrimtar dhe përkthyesi i njohur, bir i denj i Drenicës legjendare, një shqiptar i madh në mërgim, rrezident në qytetin e tekstilit Borås të Suedisë dhe përherë befasues, kësaj here na ka dhënë një gëzim të ri, duke përkthyer nga suedishtja në shqip veprën madhore historike: “I madhi Castriot ME LLAGAP Skënderbeu - Mbreti i Shqipërisë, Duka i Madh i Epirit”, të autorit Zannovich, Stephan, apo Stiepan, botuar në Stockholm të Suedisë nga Anders Zetterberg, 1788.

Botimi në shqip është realizuar në Shtypshkronjën “Lena Graphic”, Prishtinë, në të dy gjuhët: shqip dhe suedisht. Një histori e padëgjuar deri më sot, shkruar nga të huajt për Kryetrimin Gjergj Kastrioti - Skënderbeu.


Luftëtari i madh, që ngriti

në pedestal vlerat e lirisë së popujve

Janë shkruar qindra libra për jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, aqsa besoj që, edhe studiuesit e tij më të

zellshëm nuk kanë arritur t'ilexojnë dot të gjitha. Kërkohet mbase grup studiuesish dhe historianësh, që duke i lexuar ato libra, të hedhin edhe më shumë dritë mbi jetën dhe bëmat e Heroit tonë Kombëtar, për të cilin, bota, që kur ai ishte në kulmin e madhësisë së tij e deri në ditët e sotme, ka folur e vazhdon të flasë me admirimin, pasi ai ngriti më shumë se kushdo tjetër në pedestal, vlerat e lirisë, shfaqja virtyte të rralla heroizmi, trimërie, dashurie dhe besnikërie për popullin e tij të vogël nga numri, por me përmasa të jashtëzakonshme për nga vlerat e shumfishta humane, për nga virytet e besës, mikpritjes, besnikërisë dhe dashurisë së pa krahasueshme për atdheun.

Ne dhe popujt e tjerë përparimtarë ndihemi gjithnjëvlerësues dhe krenarë me kryetrimin Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, me cilësitë vjera dhe aftësitë ushtarake unike të tij. Emri dhe vepra madhështore skënderbejane, ka shekuj që qëndron e palëkundur dhe e madhërishtme, jo vetëm në monumentet, bustet e shtatoret nëpër truallin shqiptar të copëtuar, por edhe në shumë e shumë vende të botës, në sheshe, rrugë, bulevard, institucione dhe vepra historike, shkencore, kulturore e artistike. Mbi të gjitha, emri dhe vepra e tij është shkruar në zemrën e popullit shqiptar, është trashëguar dhe përcjellë në breza, duke u identifikuar përherë me lirinë. Në veprën unike të heroit tonë kombëtar, popujt e Evropës dhe të botës kanë marrë mësimin e madh e të vyer se, sado i vogël qoftë një popull, kur ai është bashkuar, kur është i motivuar dhe me një qëllim të madh të lirisë, s'ka forcë dhe fuqi që ta kthej nga rruga, s'ka fuqi që ta nënshtrojë dhe ta mbaj nën sundim. Këtë mësim të madh historik, kryetrimi ynë legjendar e provoi dhe e farkëtoi në betejat dhe luftërat e tij gjithnjë fitimtare me fuqinë më të madhe perandorake të kohës.



Sokol Demaku, poet, publicist, përkthyes i njohur

Vepra më e re për Skënderbeun, kësaj here erdhi nga Suedia

Është një libër i përkthyer me një shqipe të qartë e të pastër, që plotëson e zgjeron më tej kulturën tonë rreth personalitetit të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Si fillim, duhet të themise, vepra e Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”, e shkruar në latinisht dhe e botuar në Romë, midis viteve 1508-1510, jo vetëm e bëri Barletin të famshëm, por ajo u bë edhe burim i një literature të gjerë, të shkruar në gjuhë të ndryshme: portugalisht, spanjisht, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, serbisht, greqisht, japonisht... Për këtë veprë Barleti u mbështet tek dëshmitë e të tjerëve, dhe nga shumë studiues, Barleti u cilësua edhe burimi kryesor i veprave të tjera kushtuar Historisë së Skënderbeut. Nga ajo vepër, ata morën frymëzimin, por edhe fakte e dokumente, që ndriçonin figurën madhështore të kryetrimin shqiptar.

Duket se, edhe autori i veprës “Skënderbeu”, për të cilën po flasim, e ka këtë frymëzim e mbështetje historike nga vepra bazë e Barletit, por, ai e plotëson kuadrin figurës së heroit tonë edhe me të dhëna të tjera të kohës, që vijnë ngadokumente dhe libra të tjerë të shkruar, ashtu dhe nga episode, rrëfime e histori të dëgjua nga bashkëkohësit, kjo, sepse fama e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut ka vazhduar me shekuj dhe me një përhapje të gjerë në të gjithë Evropën, madje edhe në kontinentin amerikan, ashtu dhe në Azi, Australi e në shumë e shumë vende të tjera. Ndërkaq, libri ka “fytyrën”, mendimin dhe individualitetin krijues të Zannovich Stephan.

Nëpërmjet përkthimit, Sokol Demaku na e përcjellë Gjergj Kastriotin ashtu siç e ka përshkruar autori, të madhërishtme, me vlera që i kishte vetëm Ai dhe që ua trashëgonte trimave të tjerë përmes fjalës së mençur dhe shembullit e veprimit, duke i frymëzuar e nxitur ata drejt qëllimit të madh të mbrojtjes së atdheut, të lirisë dhe të pavarësisë.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu



Ne ndihemi kureshtarë kur Zannovich Stephan shkruan për familjen Kastrioti, për Gjon Kastriotin dhe përballjen e tij me një nga sulltanët më të fuqishëm të kohës, Muratin e II, tek ndjekim me emocion rrëfimin sesi ai la peng djemtë e tij te sulltani... “Gjergj Kastrioti, shkruan autori: - nuk ishte më shumë se gjashtë vjeç kur u ekstradua nga Perandoria turke, ai u bë synet në bazë të ligjeve të Muhamedit... E, ndërsa ai zotëronte të gjitha cilësitë e mendjes dhe të trupit... Murati tregoi një simpati të veçantë për të, duke i dhënë një edukim-mjaft të mirë”.

Ndihemi krenarë kur lexojmë se “Gjergji rritej e bëhej më i madh, edhe forca i rritej aq shumë, sa askush në vendet elindjes nuk kishte një trup më të fortë, krahe më të mbushur dhe guxim më të patrembur, sa Ai. Atij iu vu në dizpozicion një mësues mjeshtrë, i cili i mësoi Gjergjit turqisht, arabisht, greqisht, italisht, sllovenisht si dhe gjuhën latine...”

Në shkollat më të mira turke ai mësoi të përdorte armët, të kalëronte, si dhe të bënte të gjitha ushtrimet e trupit, që janë të nevojshme për të pasur sukses në shërbimin ushtarak. Ai përfitoi njohuri për veten e tij aq mirë nga ata mësues të aftë, të cilëve iu ishte besuar edukimi i tij. Në të gjithë konkurset publike, ai fitoi të gjitha çmimet konkurruese, por gjithashtu, ai çdo ditë merrte çmime të reja dhe lëvdata nga Murati. Në moshën 18 vjeçare, Sulltan Murati II e emëroi Gjergj Kastriotin komandant të mbi 5.000 kalorësve dhe e dërgoi në Azi....

Me atdheun në mendje dhe në zemër

Dhe, kështu, nisin e marrin udhë shfaqen përpara lexuesit aftësitë e mëdha luftarake, zgjuarësisia, trimëria dhe heroizmi i tij në sytë e Perandorisë së madhe Osmane dhe të vet Sulltan Muratit të II. Autori i “Skënderbeut” të shqipëruar nga Demaku, vë në dukje se, në betejat dhe fushatat që Skënderbeu udhëhiqte kundër kundërshtarëve dhe armiqve të Perandorisë Turke, ai në mënyrë të



maskuar sillej butë dhe përpiquej të mos bënte krime në zonat e të krishterëve,"ai kurseu gjakune tyre aq sa mundi".

Ndërsa Gjergji ekspozonte çdo ditë jetën e tij, Murati ishte informuar se Gjon Kastrioti, regjenti legali Shqipërisë, kishte vdekur. Murati i pabesë, mosmirënjohës menjëherë sulmoi dhe mori shtetet e tij... Gjergji ishte shumë i pikëlluar... Por ai nuk lejoi që të vihej re... Sidoqoftë, ai po mendonte për mjete, si dhe për mënyrën për të rikthyer mbretërinë e paraardhësve të tij. Ai kërkonte një mundësi të favorshme: të linte oborrin mbretëror të Muratit, të merrte në zotërim Krujën, kryeqytetin e shteteve të tij. Rasti erdhi kur Murati II ngriti në këmbë një ushtri prej 80.000 burrash, të cilën e dërgoi në Hungari. Ndërkaq, urdhëroi Caram beun dhe Kastriotin të shkonin përpara me 25 mijë burra. Huniadi do t'u kundërvihej me 10.000 burra. Kur hungarezët bënë një sulm të shpejt kundër turqve, Kastrioti, menjëherë u tërhoq prapa me trupat e tij dhe pastaj ktheu shpinën duke ikur...

Gjergji ishte nisur për në Shqipëri... Brenda tetë ditësh arriti në Dibrën e Epërme dhe hyri në Krujë, më 28 nëntor 1443.

Bir i denj i popullit shqiptar

Libri na rrëfen sesi Skënderbeu forcoi pushtetin, sesi iu drejtua popullit dhe princave shqiptarë, sesi thërriti Kuvendin e Lezhës, ku princat e zgjodhën Skënderbeun gjeneral për ushtritë e tyre, e pranuan gjithashtu atë edhe për Sovran të Shqipërisë.

Atëherë Shqipëria ishte e ndarë në principata, ku konkurrenca mes fiseve për të mbrojtur interesat e tyre ishte e dukshme. E pikërisht Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, në atë kuvend të 2 marsit 1444, duke formuar "Lidhjen e princave shqiptarë", ia arriti t'i mbante ata të bashkuar deri në fund të jetës së tij. Nisi kështu ajo udhë e gjatë fitoresh të njëpasnjëshme, që do të tregonin aftësitë legjendare të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, talentin e tij të jashtëzakonshëm dhe taktikat e tij në luftime mbrojtëse dhe sulmuese, zemrën e tij të madhe, mençurinë dhe inteligjencën, besimin te bashkëkombësit e tij besnik deri në vdekje, besimin te qëllimi i lartë i misionit të tij çlirimtar dhe, pastaj, ato mësimetë vlefshme që mori Evropa dhe bota prej veprimeve dhe atyre dhjetëra betejave të tij të guximshme. Ishte kjo famë, e cila bëri që mendjet më të shquara të kohërave të shprehen për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Kështu, në veprën e tij, Volteri shkruan se "Sikur ta kishte mbrojtur Skënderbeu Kostandinopolin, turqit nuk do të kishin mundur ta merrnin atë në maj 1453". Kurse studiuesi gjerman Fallmeyrer, shkruan se Gjergj Kastrioti paraqet "Udhëheqësin më të përgatitur, më të suksesshëm dhe mjeshtrin më të madhtë luftës".

Ky libër, në përkthimin mjeshteror të Sokol Demakut, na bënë krenarë ne shqiptarëve për Heroin tonë Kombëtar, na frymëzon dhe na nxit më shumë për dashurinë ndaj atdheut dhe besimin se, populli shqiptar ka një histori të pasur dhe të jashtëzakonshme, që bota duhet ta njoh më mirë. Për këtë duhet të jemi ne shqiptarët në radhë të parë prezantuesit e kësaj historie, jemi ne që duhet t'i trego-

jmë botës për heronjtë dhe për dëshmorët tanë, për qëllimet e tyre të larta, duke rrëfyer kështu të vërtetën dhe duke nderuar sakrificat dhe gjakun e tyre të derdhur për lirinë e vendit, por dhe për të mbrojtur Evropën nga egërsia e barbaria turke. Me veprën e tij heroike, Gjergj Kastrioti i dha më shumë shkëlqim historisë sonë, te figura dhe vepra e tij ne shqiptarët shohim portretin tonë, ndjejmë rrjedhjen e gjakut të të parëve tanë ilirë, tek ai janë edhe Bardhyli, Genti, Teuta, Glaukia... janë heronjtë dhe dëshmorët që kanë vaditur me gjak këtë

neveri ndaj atyre, që shfaqen nga llumi i zi i kënetave t'ndyra e vjellin vrerë; ndaj atyre sahanlëpirësve, pehlivanëve, "hardhucave", që nxjerrin kokat poshtë gurëve e pështynë, ndaj atyre "lepujve", që bëhen trima dhe "kruhen" si luanë. Të gjithë kanë një synim të shpifur: të njollosin gjakun e pastër arbëror, t'ia nxjerrin popullit heroin nga zemra dhe të lëkundin besimin ndaj tij. Ata kritizerë, të huajapo dhe ndonjë bukëshkalë shqiptar, bëjnë çmos ta nxjerrin Gjergj Kastriotin nga këngët e legjendat, nga librat e do-

ematdhe në rapsoditë e tij, në toponimet dhe rrëfimet që trashëgohen nga njëri brez në tjetrin; ajo është në malet, gurët e rëndë dhe kështjellat, grykat, kepat, kishat, luginat, burimet, fshatrat e krahinat me emrin e tij; ajo është në ligje, në emra ditësh të shënuara dhe festa, që mbajnë emrin e tij... Koha kur ai veproi, në fjalorin zyrtar e popullor merr emrin "epoka e Skënderbeut", kështu dhe armët e tij, mjetet e luftës, vendet ku shkelte dhe ku banonte, ku organizonte mbrojtjen dhe sulmet kundër pushtuesve. Ne sot kemi fl-



truall të dashur dhe të shenjtë.

Neveri popullore ndaj shpifësve ordinerë

Edhe në këtë libër të Zannovich, sikurse edhe në shumë vepra të tjera që janë shkruar për Kastriotin, shfaqet madhështia dhe fuqia e kryeheroit tonë në mbrojtje të Shqipërisë dhe të Evropës nga pushtuesit osmanë. Shkrimtari lartëson me fakte dhe dokumente rolin dhe shembullin unik dhe vital të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por, njëherazi duket se, në mënyrë të tërthortë, fshikullon ata individë, që u duket vetja "original" dhe vënë në dyshim emrin dhe veprën madhështore të Gjergj Kastrioti-Skënderbeut. Doemos që kenë dëgjuar, të nderuar lexues, për vaporët e mëdhenj transoqeanikë, që i bien tejprtej deteve dhe oqeanëve, që përballojnë dallgë të fuqishme dhe stuhi të lemerishme, duke triumfuar mbi to e duke çarë gjithnjë përpara? E pikërisht, në pjesën fundore të tyre, ngjiten disa tipe midhjesh të zeza, që lundrojnë së bashku me ata vaporë, si të ishin pjesë e tyre. Po, atë tjetrën e keni dëgjuar, më duket e thotë Sigmund Frojdi (1856-1939) se "miza në kokë të kalit, kujton se e tërheqajo karcocën!". Kështu, edhe ata njerëz të neveritshëm, të "krahasuar" me midhjet dhe me mizat, duke sulmuar figurën madhështore të Heroit tonë Kombëtar, u duket vetja se mund të jenë edhe ata të lavdishëm dhe madhështorë. Populli ka ndjerë gjithnjë

kumentet e shkruara të historisë, duan t'i shuajnë gjurmët e tij në gurë e kështjella, duan ta rrëzojnë nga kali e ta shkelin me thundra. Duke tentuar gjithmonë ta paraqesin Heroin tonë të zakonshëm e të rëndomtë, ata tentojnë ta zbrisin nga piedestali i lartë i lirisë!

Libri i Zannovich, që kemi në dorë, mund të themi se nënvizon thujse në çdo faqe të tij se, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, bir i denj i kombit arbëror, është njëshuar me kështjellat dhe flamurin, nderohet si prijësi dhe udhëheqësi më popullorë i kohërave. Emri dhe vepra e tij ndritin në historinë shekullore shqiptare, evropiane dhe botërore, duke shërbyer gjithnjë si një "Yll polar", për popujt që luftojnë për liri...

Vepra e Gjergj Kastriotit, është e njesuar me popullin, me truallin, me kështjellat...

Milan Shuflai, albanologu kroat, që u sakrifikua për Shqipërinë, duke folur për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, mes të tjerash ka thënë: "Është e kotë të kërkosh dokumente në Shqipëri për Skënderbeun, përveç atyre që janë shkruar nëpër shkëmbin, sepse çdo gjë që ishte e shkruar, u dogj nga turku!"

Vepra madhështore e Skënderbeut, tashmë dihet, ajo edhe sikur të zhduket çdo dokument nga arkivat evendeve ballkanike e evropiane, është në zemrat e popullit, në mitet, legjendat, po-

amurin me emrin e tij, kemi sheshe, bulevard, rrugë, tituj nderi, qindra vepra historike, letrare, skulpturore, piktorike, deri dhe vepra muzikore operistike që i janë kushtuar atij, nga artistë shqiptarë dhe të huaj. Kemi qindra toponime me emrin e tij, rrëfenja dhe legjenda pa fund me emrin e tij. Por kanë edhe vendet fqinjë, kanë edhe shtetet e Evropës, që e patën shembull apo u frymëzuan prej tij. Sikurse, për emrin, veprën dhe famën e Gjergj Kastriotit janë shprehur dhe kanë shkruar dhjetëra personalitete të mëdhenj... Vepra e Skënderbeut është kudo e, mbi të gjitha në kujtesën epopullitshqiptar dhe zemrën e tij të madhe...

Siç shprehet me të drejtë shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare: "Gjergj Kastrioti ishte prijësi më i madh i Ballkanit, absolutisht më i madh i epokës së vet. Ai ishte i pari që përpunoi me mendje të hekurt dhe vizion madhështor, rrugën e Shqipërisë, nga do të ecte ajo, nga Lindja apo nga Perëndimi... Ai... i dha vendit të tij një orientim drejt Evropës, deri në fund, sa vdiq! Ai ishte testamenti i parë i orientimit të shqiptarëve..." Dhe, si për ta mbyllur këtë tekst, po përmend fjalët e Papa Kaliksti III, i cili shprehej: "Si një pendë e patundshme, Gjergj Kastrioti ndaloi furinë e sulmeve turke dhe i pengoi të zaptinin Evropën Kristjane!"

Vijon në numrin e ardhshëm

MIRASH ZEFI NDËR RREMAT E PARË TË DISIDENCËS DUKAGJINASE

Kudo shkoi ruajti lëndën e shëndoshë të vendlinjes që vjen era rrëshirë shqiptarie

22 vite kanë kaluar nga dita kur trupi i Mirash Zefi Prekës prehet në gjirin e tokës që e lindi. Prej varrit me shtrojë dheun e zi ai, na flet me alegori e buzëqeshje të ftohtë. Na flet disidenca e tij e përvuajtur, e paharruar dhe e heshtur. Disidenca e tij pavlerësuar nga miopia, mosmirënjohja dhe rendja turr vetëm pas dëshirave materiale.

Mosvlerësimi ndaj Mirash Zefit, është harresë dritëshkurtër ndaj sakrificave idealiste të atyre që ndezën pisha në tunelin errët të dimrave më të çmendur të moteve. Mirash Zefi ishte ndër rremat e parë të disidencës dukagjinase nën hije të cilit blerojnë dhe fladitën idealet më të mira të sotmes e të së nesërme. Lindi me 30.12.1933 në Shalë (Lagje Rreth i Lekajve). Shtëpisë ku u përkund në djep druri nuk i bashkëngjitet fjalë tjetër veç mbiemrit të nyjshëm "e madhe". Vizualisht e madhe 15 pash e gjatë, dy bojë e lartë, me çati alpine pishe të rrëshinuar, me jerevi e çarranik. Një kotec drithi 4 megjësh me shpatëza e mbulojë druri i bënte roje një arë si tepsia 20 argatëshe, e cila gjallonte nga bimë të harlisura dykollomoqëshe. Poshtë tyre groshët xhufkore si inxhia, ndërsa kunguj sa koshi i dushkut mbi lozë vareshin katarosh stomeve. Shpi me shumë mashkuj, grani, djem, çika dhe gja e mallë plot si bjeshka e madhe kur vjen qershori. Në regjistrin kujtesor kulla e Ndue Sokolit dhe e Zefi Prekës ishte ndër më të mirëpërmendurat e dyerve të kamura të Shalës. Pasuria më e madhe e kësaj shpie qe bujaria dhe harmonia shembullore. Kjo pemë shekullore plot gjelbërim e fruta nuk sundohej nga ndonjë patriarkë tradicional, por dirigjohej me razi të shkëlqyer si pak kund tjetër nga Ndue Sokoli dhe Zefi Preka.

Mirash Zefi hodhi hapat e parë në jetë në malet e Dukagjinit, në hijen e aheve dhe pishave të bjeshkës ku fryn fladi si simfoni e dielli të puth e ledhaton gjithë dashuri. Atje ku veriu shfryn gjithë inat dhe ortiqet shungullimë prishin gjumin e maleve. Aty, së bashku me qumështin e lokes, thithi aromën e rapsodive dhe këngëve më të dëlira të eposit të shqipeve. Këtë krijesë të zgjuar dhe inteligjente e lindi Palinë Gjonja, motra e Nikë Gjonit nga Ndreajt e Shoshit nga oxhaqet më të mirat e këtij fisi ku vlen të theksohet Mirash Ndou që kje tretë në KerrTorobullus së bashku me krerët e Shoshit në vitin 1871. Pas çlirimit, djaloshi iu dha mundësia të ndiqte rrugën e arsimit, që për bijtë e maleve ka qënë një mollë e ndaluar nga mallkimi i kohërave arkaike.

Malësia po ndërronte faqe, analfabetizmi kishte filluar të dëjë përfundimisht, duke i lënë vendin shkollës. Shkolimi heq veset, mëninë, ushqen paqën e dashurinë. Imcaku nuk hezitoi aspak të zgjidhte mes shkollës dhe tufës së deleve. Ograjave e bjeshkës sa e sa herë qe inato-



sur ndaj atyre të pabindurave. Nuk ishin torollake si shfryene ndaj tyre kah i kërkonte, kur i iknin ose i shpërndaheshin pa adresë. Jo more jo bardhokave nuk u vliente një çoban i vogël, që habitej duke recituar rapsoditë e zharkut për Mujin, Gjergj Elez Alinë, Zukut Bajraktar apo dhe këngët e Fish-tës. Deleve dhe bariut të vogël u hyri shkolla në mes dhe i ndau përgjithmonë. Opingat e thesit dhe çorapet e leshtë i zhveshi sa shkoi te dera e konviktit "Tomë Kola". Kështu dhentë humbën një harrakat dhe shkolla fitoi një bari shembullor. Në shikim të parë s'u mbushi sy as shokëve as mësuesve, por pa vonuar u bë i pari mes shokëve dhe më i mirëvlerësuar i edukatorëve. Të nxëniet për Mirashin ishte pasion argëtues, jo angari detyruese siç konceptohej nga nxënësit dembelë ose të prapambeturit pas shokëve.

Djaloshi, shkolla ia pajisi mendjën, i fisnikëroi shpirtin, i dha dijeni dhe kulturë pedagogjike. Mësimet i bënte më shpejt se shokët, por iu shtua dëshira të dinte gjëra më të larmishme, se çfarë shkruanin librat shkollorë, prandaj gjeti strehë në bibliotekë. Shpesh, kur shokët gërhisnin në gjumë ai lexonte letërsi artistike, monografi historike, por edhe artikuj të karakterit psikologjik, pedagogjik dhe filozofik. Pasi përfundoi shkollën Pedagogjike, u emërua mësues në Dukagjin, profesion të cilin e kishte për shumë zemër. Fëmija i katundit u bë mësues i dokeve dhe i viryeteve më të mira duke punuar në Shalë dhe disa fshatra të Dukagjinit. Djaloshi i ri plot ëndrra si gonxhe të paçelura, dritën e shkollimit donte ta ndizte fshat më fshat e shtëpi më shtëpi. Mirëpo realiteti nuk ishte si ndër libra as ashtu siç propagandohej ndër gazeta. Gjyshja, gjyshi, mentaliteti ç'na duhet shkolla, vajza nuk duhet të shkojë në shkollë, delja, dhia, varfëria mungesa e ambienteve shkollorë ishin rrodhe dhe ferrca që ngatërroheshin nëpër këmbë në punën e tij të përditshme. Nuk mjaftonte vetë puna në klasë, por mësues Mirashi u bë aktivist shoqëror dhe luftëtar për emancipimin shoqëror, shpesh herë në një duel të fortë mes mentalitetit patriarkal mesjetar dhe së resë që përqafohej nga rinia, fronti, gruaja ndërkohë mbi të gjitha dirigjonte partia. Mirash Zefi ishte formuar e po afirmohej gjithnjë e më tepër si idealist i majtë. Lufta kundër analfabetizmit, gjakmarrjes, martesave me shkuesi dhe diferencë moshe, lufta për emancipimin e gruas, për higjenizimin dhe ndryshimin e mënyrës së jetesës, aksionet për hapjen e rrugëve automobilistike, hapja e çerdheve, PTT, qendrave shëndetësore, spitaleve, elektrifikimi e të tjera ishin reforma që kërkonin sakrificat më të mëdha për të ndarë mesjetën nga e ardhmja progresive. Këtë flamur e morën komunistë që kishin gjithë pushtetin dhe tagrin për të demaskuar regjimet e mëparshme, që

kishin prodhuar nga njëra anë shkëlqimin e florinjte të pasanikëve dhe nga ana tjetër ferrin e tmerrshëm të shumicës varfanjake. Për një Shqipëri të emancipuar, të shkolluar, me universite, teatro, kinema, akademi e institucione shkencore, me bujqësi e industri të zhvillua, me mirëqenie dhe pa kontraste të mëdha sociale. Për këto ideale luftoi, punoi e sakrifiko rininë e tij Mirash Zefi. Ai aderoi në parti, që të ishte më i dobishëm dhe faktor pozitiv në vendim marrje. Mirash Zefi pa u nda nga puna përfundoi mirësisht studimet e larta për histori, librin ashtu si cigarën kurrë nuk i ndau nga vetja. -Boll ke ba shkollë, tash ndaju librave,- e qortonte ndokush, kur e shihte të përhumbur në lexime.

- Po nuk lexove gjithë jetën velësh, shëmtohesh e thahesh si bima pa ujë e ushqim, - ia kthente Mirashi "dashamirit", që donte ta ndante nga librat.

Kishte lindur të bëhej intelektual dhe jo për të rritë vetin, por për ti shërbyer vendit të vet.

Kishte një oratori të peshuar, me stil të këndshëm plot gjallësi në shprehje, stil të natyrshëm të lulëzuar nga thellësia e mendimit, logjika, dhe figuracioni i spikatur popullor. Pavarësisht ligjëtimeve propagandistike tek ai, dita-ditës hidhnin rrënjë dyshimet që tinëzisht kishin nisë më gjarpëruar në mendjen dhe shpirtin e tij të trazuar. Kujtimet e Mirash Zefit janë jeta e një malësori të shkolluar e të moderuar të viteve të socializmit, janë ajo jetë e vrazhdë në qiellin e mbarsur me bubullima, që e shitoi me rrufe dhe e mbërtheu si Promete. Por ishte edhe ajo jetë e një brezi të rritur ndër shkolla, konvikte, aksione, aktivitete emancipuese, stervitje ushtarake, mbremje vallëzimi, dasma të reja, e edukuar me dashuri patriotike të vaksinuar me propagandë politike dhe urrejtje për armiqtë e pushtetit dhe botën borgjeze.

Kujtimet e Mirash Zefit ishin një kapitull i ri i jetës ndër male pa gjakmarrje, të armatosur gjer në dhëmbë, por pa armë nëpër duar, pa liri as shpërdorim vrasës të fjalës. Jetë me djersë të ballit, me mungesa të mëdha, por pa grykësi të llahtarshme. Ndërtues jo të mirë, por jo kurrsesi shkatërrues e grabitës të babëzitur. Uniformë njëngjyrësh sipas parimit të dirigjimit të tufës, por pa ekstravagancë, pa kontraste të çmendura të pjellë e harlisur brenda një dite, pa fanatizma, urrejtje krahinore, fetare deri në shpërfytyrim.

Mirash Zefi ka qënë drejtues partie, pushteti dhe ekonomie për disa vite në Dukagjin, Komitetin Ekzekutiv të Rrethit dhe stacioni i fundit qe Shllaku në detyrën e Kryetarit të Kooperativës së Bashkuar. Më të mund të flisje pa druatjtje, nuk ishte thumbues as topxhi, as mendjemadh. Sa i buzëqeshur, i dashur e mikpritës aq i rrepët dhe i papajtuëshëm me hipokrizinë, servilizmin, mendjemadhësinë, butaforinë, smirëzëzën, injorancën dhe vesin e nënshtrimit pa kushte.

Kishte aftësi që secilit t'i vinte plisin që meritonte: plakut, të urtit, të riut, dallkaut apo thundër mushkut. Të keqit i shmangej me elegancë dhe nuk i dilte turr përpara, por kur kosi nuk mbante më ujë nuk tundej vendit. Mirashi punonte e punonte si gjenerator me vullnet me korrektësi e drejtësi duke qënë gjithnjë sa më afër njerëzve nevojtarë. Mirashin nuk e lodhnin, as pagjumësia, as udhët e gjata, as mbipesha e planeve abstrakte, as vrapit brigadë më brigadë, as puna me njerëzit. Shpirti delikat i intelektualit liberal, që lexonte, shkruante, pinte, vallëzonte, dashuronte kishte kohë që ishte zhytur në trishtim në mes trazimi të pashpresë. Ëndërrimtarit dhe këngëtarit të një botë humane për drejtësi e barazi shoqërore, asnjë ëndërr nuk i doli e vërtetë në zhgënjendërr. Kënga e bylbylit po i behej vaj qyqje. Ngado që shkonte e kudo që hidhte hapin shkelte në llavën e përflakur dhe thëngjij të përgjakur të luftës së klasave. Pas luftës vigjilente të klasave fshihej çdo gënjeshtëri dhe dështim. Diktati politik kishte betonizuar ateizmin, ndry me kolkoz fjalën, shkelë më këmbë të drejtat dhe liritë më themeltare të njeriut. Servilizmi, mashtrimi e varfëria që thellohej dita ditës ishin kthyer në vargoi mbërthyes për këmbët dhe duart e popullit, në emër të të cilit kryheshin krimet me monstruoze ndaj tij. Pati një shpresë të fundit për një kthesë liberale në vitet shtatëdhjetë, por plenumet dramatike të viteve 1973 e 1974 rrafshuan gjithçka si orteku që shtriu pamëshirshëm picakët e imshhtës. Gjithë ngrehina e idealeve të tij ishte shembur. Ai e kuptoi se gjithçka ishte thënë, shkruar dhe propaganduar për komunizmin paska qënë një rrenë e madhe politike globale. Kur ishte në kulmin e karrierës dhe në vitet më vitale të jetës Mirash Zefi pati zgjuarsinë të ngrihej mbi vetvetën kur tha: "Komunizmi vdiq qysh ditën që Krishti u var në Kryq. Komunizmi është utopi e navitetit njerëzor ose fantzëm rrënuese e njerëzimit".

Mirash Zefi u shqua si protagonist në situata tepër të koklavitura, ku luftohej për jetë a vdekje mes familjes së luanëve. Duke qënë komod në radhën epërme të vagonëve të pushtetit doli prej shinave vetëm se nuk pranoi të komprometonte dhe kriminalizonte shpirtin dhe personalitetin e vet. Sa maçokë hileqar kanë fituar medaljën e trimërisë së luanit për epope të trilluara, sa rapsodi e çifliqe pushteti kanë poseduar të vetëquajtur heroit e nëntëdhjetës, që asnjë shputë nuk ua dha kush gjatë revolucionit të lavdishëm që përmbysi diktaturën e vetvlarë.

Pa koment, ja çfarë shkruhet në dosjen e tradhtarit, armikut të popullit dhe revizionit Mirash Zefi, i arrestuar në pikun e goditjes së grupeve të puçistëve të ushtrisë, sabotuesve të ekonomisë.




(Vijon në numrin e ardhshëm)

Prelë Milani

Pjetër Shpani ishte princ i Shalës dhe Shoshit

Kur themi princ i kësaj principate nuk duhet të kuptojmë sot kufinj të e ngushtë territoriale në të cilat përmbledhet ky emër. Kufinj të principatave tona kanë ndërruar disa herë emër dhe kufinj, si nga luftërat civile ashtu dhe nga dhënja e këtyre principatave herë njërit princ herë tjetrit nga sundimtarë të jashtëm. Familja Shpani përmendet në shumë shkrime si një familje Shkodrane sundimtare e kësaj principate.

Në shumë shkrime jo dashamirëse gjejmë që Pjetër Shpani nuk la trashëgimtarë, por Pjetër Shpani la katër djem: Lekën, Bozhdanin, Oroshin dhe Markun. Këtë e pohojnë shumë, por këtu do sjellim dy dëshmi. Njëra vjen nga Bostoni i Amerikës i shkruar nga Francesco Argondizza në 1820, ku thotë se Pjetër Shpani mori pjesë në Kuvendin e Lezhës me të katër djemtë e tij të përmendur mësipër. Kjo do të thotë se këta ishin me potencë dhe gjithsecili duhet të ishte zotëruar i një pjese të principatës së të jatit. Legjendat e këngët thonë që dikur Shoshi, Shala e Mirdita ishin bashkë, dhe kjo dokumentohet, sepse edhe sot Oroshi është pjesë



e Mirditës dhe dubet të ketë qen princ i sajë, Orosh Pjetër Shpani.

Edhe Rolando Fabrini në "Scanderbeg 1405-1468" dëshmon po të njëjtën gjë. Duhet një studim i mirëfilltë në arkivat e

Venezias, për të njohur këtë familje princash të Shalës e Shoshit dhe të Mirditës. Shumë mbiemra Shpani-Spani gjenden dhe në itali mbase passardhës të tyre janë shpërngulur nga Shqipëria pas vdekjes së Skënderbeut.

Diçka interesante është se dhe një familje piktorësh të famshëm me mbiemër Gionimi në Itali të lindur në Lezhë rreth

viteve 1600, thonë që janë me origjinë nga familja princërore e Shpanëve të Shkodrës. Pra, dhe djemt e Shalës, Shoshit dhanë një kontribut të çmuar në Besëlidhjen e Lezhës, edhe pse intrigat e kohës i kanë vënë shpesh herë kundërshtarë, mes vetes, vëllezërve dhe princave të tjerë shqiptarë.

Përgatiti: Dr. Nusha Zhuba - Romë

PENSIONISTËT TË ZHËNËYER

Mbi 650 mijë pensionistë, të cilët janë akoma gjallë, prisnin nga Qeveria "Rama 3" Të u kthehej buzëqeshja. Këtyre gjysheve e gjyshërve, të cilët ndodhen në një gjendje të kufijve të mbijetesës. Dhe që kanë sakrifikuar shumë për vendin. Po të njëjtën gjë mund të themi edhe për invalidët etj. Po me sa duket edhe këtë radhë buzëqeshja është tharë në buzë, sepse sipas programit të miratuar para disa ditësh të qeverisë e dale nga zgjedhjet e 25 prillit, e ardhmja nuk të ngjall optimizëm! Në bisedat e zhvilluara me pensionistet, ata shprehin hapur zhgënjimin dhe numërojnë hallet e tyre jo të pakta. Me 18000 lekë, çfarë mund të bëjmë? Kur paguajmë: Drita, ujë, qira, ilaçe etj. As për të ngrënë bukë thatë nuk na del. Falë emigrantëve të cilët kujdesen për ne, se po të ishte për Qeverinë aktuale, edhe për ato që kanë ikur, 70 për qind e pensionistëve do të ishin akoma më keq. Po rritja e pensioneve me 5 për qind në vit për katër vitet e ardhshme. Le t'i referohemi një pensionisti që merr pension 20000 lekë në muaj. Me rritjen e premtuar do marrë 21000 lek ose 9 bukë gruri, në muaj, ose 300 grame bukë në ditë.

Nuk paska mundësi Qeveria të hedh një hap të guximshëm në skemën e pensioneve? Fajin e paska skema e

vjetër e pensioneve, Deri kur fajtor do jenë qeveritë paraardhëse? Urojmë që të mos fillojnë nga viti 1938. Qeveria nuk ka pse të merret me të shkuarën, se një shi që bie nuk done çadër. Le të kthehemi në 2014 e deri tani sa janë rritur të shkretat pensione. Sytë i kanë të Qeveria, duke thënë: Kur do vij dita për të mos u rënë në qafë fëmijëve emigrant, të cilët tani kanë ndërtuar familjet e tyre. Edhe ata kanë problemet e veta. Ne nuk na mjaftojnë fjalët e mira të qeveritarëve, sa nuk përlohen! Po ku t'i gjejmë paratë? Po sa e sigurtë është edhe kjo rritje? Për 4 vite, do rriten 20 për qind më shumë se janë tani. Që të arrihet ky objektiv, duhet të ndryshojë Ligjin e sigurimeve shoqërore, i cili nuk lejon rritje të pensioneve përtej normës së inflacionit dhe së dyti, duhet të gjenerojë fonde të mjaftueshme për këtë qëllim! Në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 pësoi një ulje 3.2 për qind, duke llogaritur edhe efektet e inflacionit, ulja reale është më e madhe. Borxhli për këta pensioniste është Qeveria Rama. Pasi e dine forte mire se 70 për qind e tyre kanë votuar PS. Pjesa më e madhe për hir të zakonit, duke qene të majtë historikisht.

Pra, bonusi i fund vitit i cili u publikua nga Zv/kryeministri dhe do jetë 5000 lekë të rijnë. Pensionistet duke blerë gazetën Panorama ishin të kënaqur! i "fituam" dy gjela deti për 4 vjet!!!

Tani janë rritur edhe shpenzimet për artikulat e shportës të cilat janë

bazë e të ushqyerit. Kjo rritje, përveç artikulave të shportës, ka ndodhur edhe në artikulat e tjerë: energjia elektrike, gazi, etj. Deri tani shpenzimet për ushqimet arrijnë deri 50 përqindje të buxheteve të familjeve të varfëria e të mesme. Se pushtetarët, oligarkët, bosat e krimeve e të narkotikëve nuk pyesin për çmimet. Madje sa më të larta çmimet aq më lehtë, kryejnë veprën tjetër kriminale, atë të pastrimit të parave. Politika e bonusit të pensionistëve, do të kthehet në një politikë permanente të rritjes së pensioneve, përtej indeksimit, pa rrezikuar skemën dhe reformën e arritur. Bonusi mbetet ai të cilin e cituam më lartë. Është absurde të thuash se nuk ka pasur një përmirësim në skemën e pensioneve. Futja e minatorëve, metalurgëve,, naf-tëtarëve të cilët kanë statusin e tyre të veçantë. Pa paragjykuar vështirësitë që kalojnë vendi me tërmetin e pandeminë, të cilat preken jo pak edhe pensionistet, madje shumë e shumë prej tyre kanë hyrë në borxhe deri në fyt për t'u kuruar, shuma të cilat i kanë kaluar të 1000 E. Krahas shtimit të punësimeve dhe rritjes të kontributeve. Mendojë se edhe ulja e shpenzimeve sidomos të atyre të administratës lartë, parlamentit etj. Vend për të ulur shpenzimet ka plot, po të jetë dëshira dhe vullneti i mire i të gjitha palëve. Reforma territoriale të cilën opozita e braktisi, me qëllim a pa qëllim nuk dihet! Po një gjë është e qartë se ulja e shpenzimeve në bashkimin e komunave është fare minimale, për

të mos thënë hiç. Ose për të qene i sinqerte, shpenzimet janë më të larta se ato para reformës territoriale. Në uljen e shpenzimeve mendojë se duhet filluar nga kupola. Pse u dashkan 140 parlamentar? Kur shumë mire mund të bëhesh fjala vjen me 100 parlamentar. E të kursesh rreth 150 milion lek në vit, duke ulur ose larguar 40 deputet. Sa vende mund të shkurtohen në dikasteret qeveritare, në qarqe, prefektura, drejtori bashki etj. etj. Kuptohet se duhet ndërhyrë në kushtetutë. Nuk janë problem ndërhyrjet në Kushtetutë, se është bërë si "thesi i Çudit" duke arnuar vend e pa vend.

Rritja e pensioneve me 5 për qind në vit dhe që varijon nga 350 lek deri në 1500 lek është minimale e përsëri ne themi më mire pak se hiç!!! Po shpresojmë se ligjvënësit dhe qeveria do mendojnë se do plaken dhe do të dalin në pension një ditë. Të mendojnë për të afërmit e tyre. Se për vete kanë menduar forte mire. Se edhe pasi të ikin nga parlamenti, kanë shumë privilegje, kulminante është se edhe kur të dalin në pension, ata marrin një pension sa katërfishi pensionit mesatar!!! Një gjë është e vërtetë si drita e diellit, se po nuk u morën masa të menjëhershme, për shtresat e varfëria dhe të mesme., do mbetemi te thënia, e rëndë "Shterngo rripin Thanas!!".

Ndue Ziçi

Një portret i panjohur i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në Muzeun e qytetit të Fermos, në Itali

Me datë 11 deri 14 tetor shkova për një vizitë studimore në Bibliotekën Komonale "Romolo Spezioli", në Arkivin Dioqezan dhe në Muzeun e qytetit të Fermos në Itali. Kjo vizitë më solli një befasi të këndshme, që nuk e kisha imagjinuar. Në murin e sallës së muzeut, krahas dhjetëra portreteve të personaliteteve të ndryshme nga Italia dhe nga vende të tjera, ishte i ekspozuar edhe një portret i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti -Skënderbeu. Ky portret ndoshta do të më kishte shpëtuuar pa e parë, por ishte një rastësi se si ndodhi që unë munda ta shikojta.

Midis librave që unë kam dërguar si dhuratë bibliotekës dhe arkivit ishin edhe libri im "Skënderbeu, letërkëmbimi me Sulltanët" dhe disa albume mbi Skënderbeun. Kur unë i dorëzova Kryetarit të Provincës së Fermos, Paolo Calcinaro një album me ngjyra për Skënderbeun shkruar në gjuhët shqipe dhe angleze, ai më falenderoi dhe u shpreh se në muzeun e qytetit kemi të ekspozuar një portret të Skënderbeut. Unë menjëherë kërkova që të më mundësonin ta shikonja.

Kryetari më shoqëroi në sallën e madhe të mbledhjeve të muzeut ku ishte i ekspozuar portreti.

Në murin përballë derës hyrëse, në rreshtin e parë, ky portret ishte i vendosur i dyti midis disa dhjetëra portreteve të tjera. Ishte i rrethuar me një kornizë druri shumë të vjetër dhe të shkruar në anën e poshtme me gdhendje shënimi "SCANDERBERG GIORGIO 1414 + 1467".

Reagimi im ishte i menjëhershëm për datën e lindjes dhe të vdekjes së heroit, që sipas meje, ishin të shënuara gabim që të dyja.

Punonjësit e muzeut, krejtësisht të qetë më dhanë sa mundën shpjegimet e tyre mbi reagim tim. Menjëherë më sollën një katalog me ngjyra ku ishin të botuara fotot e të gjitha pikturave me një shpjegim të shkurtër për secilën prej tyre. Në katalog, poshtë fotos së portretit në fjalë, ishin të shënuara me korrektësi, sipas njohurive që kisha unë, data e lindjes dhe e vdekjes, 1405 dhe 1468.

Kur pashë katalogun u binda menjëherë që ndërhyrja ime ishte e pa nevojshme dhe nuk u zgjata më në këtë diskutim.

Ata, me shumë mirësjellje më shpjeguan se ky portret ishte dhuruar, sipas dokumentit që ata kishin, nga një prift në vitin 1550, pra 471 vjet më parë dhe ky ishte një objekt historik mbi të cilin nuk duhej dhe nuk kishte kuptim të vihej dorë.

I falenderova për pritjen dhe për shpjegimet që më dhanë dhe u largova i kënaqur që shikoja një portret të Heroit tonë Kombëtar, të cilin nuk e kisha parë ndonjëherë.

Në vijimësi, mësova se ekziston në një muze tjetër edhe një portret i Skënderbeut me rroba kombëtare të zonës fushore të Shqipërisë së Mesme. Kur i pyeta se në cilin vend ndodhej, rezultoi që ishte 500 kilometra larg dhe unë në këtë vizitë nuk munda të shkoj për ta shikuar.

Jemi marrë vesh që do të kryej një tjetër

udhëtim të planifikuar në Itali, posaçërisht për këtë portret sapo të jetë e mundur.

Simbas konsultave me specialistët e pikturës, ky portret ka mjaft veçanti, të cilin e bëjnë shumë interesant qoftë në aspektin historik, qoftë në aspektin artistik si një portret i punuar me teknika shumë të veçanta.

Piktorit i njohur nga Mirdita, Pjetër Marku, kur u njoh me këtë portret u shpreh:

"Nuk e kam ndeshur ndonjë herë këtë portret dhe është i panjohur edhe nga unë në gjithë njohjet e mia të pikturave



kushtuar Gjergj Kastriotit. Portreti nuk ka autor dhe si duket autori nuk e ka nënshkruar siç ka ndodhur jo rrallë në periudhën e Rilindjes Evropjane. Piktura është një portret i mirëkompozuar, një arritje kjo e periudhës së Rilindjes. Piktorët atë periudhë i kushtonin shumë kujdes vendosjes së pikturës në telajo si një gjuhë e veçantë komunikimi. Madje ishte kthyer në kanun kërkesa për kompozimin e veprës në telajo. Piktorët përllogaritin saktësisht vendosjen e figurës si edhe hapësirat brenda dhe për rreth sajë. Ky portret është vendosur mirë sipas atyre kërkesave dhe eksperiencave të kohës. Së dyti, vizatimi i portretit është i ngjeshur saktësisht i vizatuar me kërkesë profesionale. Autori duhet të ketë pasur eksperiencë pune të gjatë pasi ka ruajtur fort mirë raportet kokë-tors. Ana piktorike. Bie në sy sfondi i pikturës i errët gjë që është bashkëkohor i periudhës klasike italiane, dhe trajtimi koloristik ka profesionalizëm. Në vështrimin tim, ky portret paraqet interes si vepër kushtuar Gjergj Kastriotit, ndërsa përta i përket trajtimit koloristik, është në zhvillimet e pikturës së kohës. Përshtypja ime është trajtimi i veshjeve në kontrast më fytyrën. Piktori në mbajtjen e mbulesës së kokës ose kapeles si edhe në veshjen ruan një raport profesional. Mbi kokë ka një kësulë të kuqe shumë të pikturuar impulsive, por që lejon portretin të evidentohet si plan i parë ashtu si edhe veshja e Gjergjit, mes atyre të errtave dhe evidentohen lehtë. Pa hyrë në portretin kam bindjen se autori ka qënë me eksperiencë të gjatë pune si piktor. Në portret apo fytyrë kemi një gjendje

tjetër. Klasikët ndriçonin idenë themelore të veprës, ato kryesisht i shihnin me dritë dhe ngjyrat të thjeshta pa shumë kolorit, por komunikuese me vizitorin. Tek portreti sido që ka kujdes të madh në vizatim është mbajtur thuajse monokrom, pa shumë kolor, dhe në një gamë larg gamës së vëshjeve. Por duhet parë me syrin e piktorit. Ai është një portret me psikologji optimiste, sytë i qeshin figurës. Ai krijon një portret imagjinatë të përafërt me këtë pikturë. Në pamje të parë duket i thjeshtë, komunikues, me kolor të përmbytur, që vjen nga përvoja krijuese e au-



torit. Autori e shpreh Gjergj Kastriotin shumë njerëzor si një qytetar më shumë se një luftëtar. Nuk përdor atë përkrenarën dhe veshjen e hekurt që jemi mësuar t'a shohim në portretet e tjera. Siç duket autori kishte në veprat e tij psikologjinë e njerëzve të thjeshtë pa sforcime historike e luftëtari. Unë e shoh në tërësinë e vet këtë portret një vepër tjetër unike kushtuar Gjergj Kastriotit. Dhe duhet të jetë e fundit të shekullit XV apo mesi i shekullit XVI. Gjithnjë, duke njohur vepra të asaj periudhe, moshë e kësaj pikturë është e madhe. Për mua ardhja e një portreti tjetër nga arkivat Italiane për Gjergj Kastriotin, tregon miqësinë njerëzore të tij me Italinë. Vetë fakti, se merret edhe një piktor tjetër ndër shumë piktorë me figurën e tij kjo ka domethënie të madhe. Gjithsesi gjendemi para një veprë arti me vlera historike të hershme artistike dhe kontribut në historiografinë e artit figurativ kushtuar Gjergj Kastriotit."


Studjuesi i njohur Fotaq Andrea u njoh me këtë portret nga miku ynë i përbashkë Z. Hasan Aliaj, botues prej njëzet vjetësh i gazetës letraro historike "Rrënjët" në Itali. Ai duke analizuar këtë portret është shprehur:

"Të falenderoj ngrohtesisht që më dërguat portretin e Skënderbeut zbuluar këto ditë nga z. Mark Palnikaj në muzeun e Fermos si dhe shkrimin shoqëruar për këtë portret.

I shpreh me këtë rast, përgëzimet e mia z. Palnikaj për botimin e veprës së tij "Skënderbeu dhe letërkëmbimi me Sulltanët", i cili për fat të keq ende nuk

më ka rënë në dorë, si dhe për zbulimin e vyer që ai ka bërë në Fermo të portretit aq të veçantë të Skënderbeut, të cilin ma dërguat me dashamirësi.

Pa dyshim, ky portret është i Shkollës Italiane të fillimit të shekullit XVI dhe menjëherë bie dukshëm në sy pozicioni me profil nga e djathta e personazhit, që është shfaqur për herë të parë në medaljonin e v. 1467-1468 botuar në koleksionin e Pietro Voltalinës dhe studiuar me imtësi nga prof. Lutfi Alia. Po ashtu, bie në sy edhe etiketimi SCANDERBERG GIORGIO



1414 + 1467, dëshmi e hershme e një emërtese me ndikim franko-flamand kur mbaresa BERG shpreh një origjinë fisnikërore të familjeve të mëdha të Perëndimit dhe që e gjejmë për herë të parë tek emertesa "Pirgu i Scanderbergut" në Savoje të Francës me 1448, si dhe më vonë tek botimi i veprës së Barletit në gjermanisht, ilustruar nga Jorg Breu i Riu me 1533.

Për këtë mbaresa SCANDERBERG ka tërhequr vemendjen që heret Faik Konica tek Albania e tij e famshme.

Sa për datën e lindjes me 1414, dihet se ky variant i pasigurt ka qarkulluar që heret në shekullin XVI e që lidhet me moshën e marrjes peng të djaloshtit Skënderbe (studjuesi Hammer këmbëngul për v. 1414 si vit lindjeje i Skënderbeut), kurse viti 1467 i vdekjes, dihet që jepet sipas kalendarit të vjetër venecian.

Çfare bie në sy konkretisht tek ky portret i Skënderbeut zbuluar nga z. Palnikaj?

Duhet të jetë i periudhës kur është pikturuar edhe portreti i Skënderbeut mbi portën e shtëpisë ku ka bujtur në Romë, duke parë midis dy portreteve njëfarë analogjie pozicionale dhe veshjeje, sidomos tek tipari i hundës, që na jepet disi e drejte, pa kurriz, por me majën disi të rënë, krejt ndryshe nga portreti në ksilografi tek Barleti i v. 1510, që e shfaq Skënderbeun "legjendar" me hundën e theksuar akilne, një sajësë kjo ala Barletiane...

Është sigurisht me veshje veneciane, por fundi i sha-

SILVIKULTURA DHE MBROJTJA E PYJEVE, FUNKSIONE TË NJËRA TJETRËS

Dhjetori - "Muaji i harruar i Pyjeve"



Doc. Bajram Xheko

Në të gjitha etapat e rritjes, pylli përballet me rrezikun potencial të efektit shkatërrues të zjarreve, me dëmtimet që shkaktojnë sëmundjet dhe insektet ksilofag të lëndës së drurit dhe të gjetheve, duke shkaktuar tharjen komplet të drurit në këmbë.

Të gjitha këto, silvikultura i ka objekt të saj, i studjon dhe i trajton si pjesë përbërëse të një rëndësie të veçantë. Është me shumë rëndësi që silvikultura t'i mbrojtë grumbujt pyjor nga këta armiq të rrezikshëm në çdo masiv pyjor, në çdo ekonomi pyjore, në të gjitha pyjet e Shqipërisë, me shpejtësi, me profesionalizëm dhe me efektivitet të lartë, duke përfshirë edhe pishat e Dukagjinit për të cilat bëhet fjalë në artikullin "Pishat e parkut Ndërlysa po vdesin në sytë tanë", shkruar nga Prelë Milani, botuar në "Gazeta Dukagjini", nr. 212, Qershor 2021 dhe riprodhuar në numrin 196 të gazetës "Kurora e Gjellbër". Është një shkrim brilant kush-tuar dashurisë për pyjet, përzier me keqardhjen dhe brengën që shpreh autori për lënien e këtyre pyjeve në mëshirë të fatit.

Është një shkrim origjinal nga pikëpamja letrare ku tingëllojnë aq bukur dialektalizmat dhe zhargonet lokale Dukagjinase dhe Shkodrane të cilat, jo vetëm e zbukurojnë dhe e hijeshojnë përmbajtjen por edhe i japin forcë, e amplifikojnë mendimin dhe e mbushin atë me emocione. Në këtë shkrim paraqitet dhe denoncohet fuqishëm dhe pa doreza një e vërtetë e hidhur mbi gjendjen ku janë katandisur pyjet e bukura të pishës në një park të Dukagjinit, një pasuri e çmuar e braktisur nga të gjithë, të cilës i rrezikohet ekzistenca nga procesionaria (Thaumetopoea pityocampa) që ka mbulluar me pëlhurën e saj të bardhë halat e

gjellbërta dhe po u merr frymën. Përveçse e ka shkruar me një pasion e zell shembullor për t'u patur zili, autori ka shprehur dhembshurinë dhe zemërimin ndaj indiferentizmit për mosmarrjen e masave preventive dhe kuruese kundër këtij dëmtuesi të rrezikshëm i cili, siç dihet, vepron me intensitet dëmtimi të lartë dhe i çon me shpejtësi drurët e pishës drejt tharjes. Ky dëmtues i rrezikshëm është prej kohësh objekt shqetësues i silvikulturës europiane dhe sidomos i zonës juglindore, e cila po përballet dhe po lufton me të. Po Shqipëria? Po Dukagjini? Është për këtë arsye që silvikultura e sotme nënvizon se, "pylli me më shumë përfitime nuk është domosdoshmërisht ai që dallohet për potencial të lartë rritjeje apo pylli prej të cilit vjelim me çmimet më të ulëta produktet dhe benefitet që n'a ofron". Kjo direktivë e silvikulturës gjen konkretizim kuptimplotë tek pishat e Dukagjinit. Vlera më e madhe e këtyre pyjeve-park nuk është prodhimi i masës drunore por roli i pazëvendësueshëm ambjentalist që ato luajnë. Drurët pyjor në Dukagjin janë gardianët më të mëdhenj e më të fuqishëm të natyrës, që ruajnë ekuilibrin dhe bukurinë e saj. Pa drurët nuk ka ekuilibër mjedisor, nuk ka oksigjen, nuk ka turizëm, nuk ka zhvillim ekonomik, nuk ka mirëqenie për banorët e Dukagjinit. Këtë rol të rëndësishëm e jetik për atë zonë duhet t'a sigurojë për t'u luajtur, silvikultura dhe teknika e mbrojtjes së pyjeve, pa ndërprerje, me efektivitet dhe sa më plotësisht. Shkrimi i botuar në gazetën Dukagjini është i shkurtër, i koncentruar por me konsistencë të lartë, që të jep fotografinë me sfondin e gjellbër të peizazhit, bashkë me problemin shëndetësor që kërkon t'a zhbëjë e t'a shkatërrojë atë mrekulli që ka krijuar natyra prej mijra vjetësh. Është një shkrim që penetron, pa u menduar shumë, në ndërgjegjen dhe psikologjinë e çdo specialisti që e dashuron profesionin dhe kërkon të jetë sa më efektiv dhe i dobishëm në shërbim të tij. Janë këto vlera reale të shkrimit që më japin kënaqësi dhe më ftojnë të riprodhoj disa pasazhe të tij:

"Po ku je moj Dilë Picja? Po mana po vdesin...për së shkreti si mall i pa zot. Ato po piskatin: Ndhimë se mbaruan! Po kujt t'i thërrasin ato bukuroshe të shkretat?! Askush nuk ka gojë, askush nuk ka forcë t'u shkojë në ndihmë. E pra, syri lotit trishtohet përpara një epidemie vrase

bash në hundën tonë krenare. Pishat e Gagut, Lekajve, Ndërlyses dhe Thethit ku shumë, e ku pak më lehtë janë goditur nga procesionaria. Epidemia ka vite që është shfaqur...duke shkakuar dëmtime të pa riparueshme. Inspektorati i pyjeve në qarkun e Shkodrës nuk ka asnjë të dhënë sa është në shifra sipërfaqja e prekur, në se do të ketë ndërhyrje nga toka apo ajri. Siç më tha një mik specialist pyjesh procesionaria e dëmton pishën në mënyrë të pakthyeshme nëse nuk ndërhyhet në kohë...Parku halor hirplotë i Thethit dhe i Ndërlyses si pjesë...e florës sonë alpine po vdes!...Heshtje, heshtje dhe kapitullim pa kushte ndaj një fatkeqësie jo të pa përbalueshme. Askush nuk e merr mundimin të bëjë diçka, as ata që paguhet të menaxhojnë pyjet...Unë po thërras sa të kem fuqi. Po kujt me i thirr ndihmë...? Besa askush veç teje moj Dilicë nuk mendon as për pishat...as për hallet e vegjëlisë... Oj Dile! Oj sojnikë e moçme, çohu nga amshimi dhe na sjell shpëtimin mjedisor! Thethi dhe aq më tepër Zalli i Ndërlyses po të zhvishen nga kostumi halor, marrin pamjen e një klluçe pa pupla, që do të thotë tragjedi turistike. Çohu oj Dilë..."

Më e pakta që duhet bërë për pishat e Dukagjinit është shndërrimi i këtij shkrimi në një pamflet, pa shtuar dhe pa hequr asnjë fjalë, pa bërë asnjë lloj redaktimi letrar, pa ndryshuar stilin dialektik verior aq të bukur e tërheqës, dhe të gjendet mundësia për t'i dërguar nga një kopje Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të bujqësisë, të turizmit, të shëndetësisë, kryebashkiakut të Shkodrës, qendrës administrative të Dukagjinit, shoqatës natyraliste-ambjentaliste, çdo specialisti shqiptar të pyjeve. Është e nevojshme që njerëzit, në radhë të parë ata që e drejtojnë dhe e qeverisin Shqipërinë, shtetarët, pushtetarët dhe të ashtuquajturit politikanë, në qendër sidomos por edhe në bazë, të mësojnë e të kuptojnë se çfarë është procesionaria e pishës dhe sa e rrezikshme dhe vdekjeprurëse është ajo, jo vetëm për drurët pyjor, por mbi të gjitha për impaktin negativ që ushtron mbi peizazhin natyral të zonës dhe psikologjinë e banorëve që jetojnë për rreth këtyre pyjeve, të cilët janë mësuar të bashkëjetojnë me to prej shumë brezash dhe të përshëndeten instiktivisht me gjelbërimin pyjor sapo agon dita dhe deri sa perëndon dielli dhe bie muzgu i mbrëmjes. Këtë aspekt shëndetësor të banorëve të Dukagjinit e ka shpre-

hur gazetari me mjeshtëri, me metaforën e shkëlqyeshme dhe thumbuese, nëpërmjet "Dile Sojnikut". Personat apo institucionet e sipërpërmendura shtetërore e shoqërore, lokale apo qendrore që janë të ngarkuara me administrimin e pyjeve apo kanë lidhje me to, është e nevojshme të reflektojnë mbi këtë shkrim, të zgjohen nga letargjia, mepshtësia dhe indiferentizmi kronik dhe t'i dalin zot pyjeve dhe natyrës së egër e magjepsje të Dukagjinit. Kuintesenca e këtij shkrimi është paradoksi "pyjet braktisen nga pylltarët dhe mbrohen me pasion të flaktë nga gazetarët", që të kujton fabulat e La Fontaine të shekullit të XVII. Autori që ka shkruar këtë shkrim fantastik, edhe pse nuk është specialist pyjesh, e prezanton qartë veten e tij jo vetëm si një natyralist i vërtetë por edhe si atdhetar e patriot, një admirues i pyjeve, që frymëzon dhe vë në mendime çdo shqiptar që i dhimbset pasuria e popullit. Si specialist dhe qytetar i atij vendi, kam kënaqësinë e veçantë t'a përgëzoj gazetarin e këtij shkrimi dhe t'a falenderoj për ndihmën konkrete që i jep pyjeve dhe mjedisit natyror, që është i lidhur direkt me turizmin pyjor. Uroj të lexoj nga ky autor i nderuar shkrime të tjera në ndihmë të pyjeve dhe të natyrës tonë të bukur dhe magjepsje të bekuar nga zoti, që janë ende virgjër dhe të pashfrytëzuara plotësisht sipas kriterëve shkencorë dhe rregullave strikte administrative. Po si i shikon bota pyjet dhe si përpriqet t'i zgjidhë problemet që lidhen me to? Vendi ynë i ka pyjet dhuratë nga natyra dhe nuk i mbron dot nga rreziqet. Vendet e tjera, jo vetëm i mbrojnë por edhe shpenzojnë shumën të mëdha parash për t'i shtuar ato. Meqenëse jemi në këtë temë, është rasti të theksoj se, në datën 6 Korrik 2021, televizioni anglez BBC, në emisionet e mbrëmjes, transmetoi një informacion shkencor të zgjeruar, në të cilin bëhet fjalë për të dhënat e studimeve shkencore të kryera kohët e fundit në fushën e silvikulturës në Karolinën e Veriut, sipas të cilave rezultojnë se, shtimi 20% i pyllëzimeve të reja rrit mesatarisht 7.6% rreshjet e shiut. Mund të imagjinohet lehtësisht, po u bë një shtesë e tillë në pyllëzime nga të gjitha shtetet e SHBA, nga të gjitha shtetet e Europës, të Azisë e deri në Australi, se çfarë përmirësime të mëdha do të kishte klima dhe sa përfitime e dobi do të kishte prej tyre shoqëria njerëzore.

misë shfaqet i plotë nën kapele, më e lartë kjo nga kapa e zakonshme ku KryeHeroin shqiptar na shfaqet në portretet origjinale.

Mosha e Heroit jepet më e re, me mollëz të dalë kockore dhe me fytyrë muskulore disi të tërhequr, ku bie në sy hunda edhe buza e poshte hollake, krejt ndryshe nga "Skënderbeu" i Altissimo-s apo nga "Skënderbeu" i Pinakotekës së Palermos, por që ngjan shumë me portretin e Skënderbeut të shekullit XVI referuar

nga F. Kenner, me dallimin se bebja e syrit tek "Skënderbeu" i Fermos nuk shfaqet e plotë, gjë që le njëfarësoji për të dëshiruar, nëse i besojmë fotografimit që na dhuron publikisht z. Palnikaj. Ndriçimi i faqes, dhe po ashtu i pjesës së ballit dhe të hundës është i ëmbël dhe kontraston dukshëm me krejt pjesën e pasme të errët të imazhit dhe të sfondit, ku është harmonizuar po ashtu edhe e bardha e shamisë nën kapele si dhe mustaku dhe mjekra e shkrifët dhe e derdhur.

Një vëzhgim i ngulët tek pjesa e mjekrës dhe e mustakut, si dhe tek pjesa e gëzoftë na shfaq një punë mjeshtërore artistike, ku i është kushtuar kujdes detajit, për ta dhënë sa më të natyrshme, me njëfarë ndikimi nga Van Dyk-u.

Këto mund të them në përgjithësi nga një shikim i parë i këtij portreti të ri të Skënderbeut realizuar me porosi nga një fisnik i lartë tek një piktor mjeshtër i shkollës ndoshta napolitane që fakteqësisht mbetet hëpërhe anonim..."

Shpresoj që në të ardhmen, studjues të tjerë dhe njohës në hollësi të artit të pikturës do ta studjojnë me vemendje dhe do ta thonë fjalën e tyre për këtë portret. Gjithashtu, ju premtoj se do të bëj çeshtë e mundur që sa më parë, të prezantoj edhe portretin tjetër të cilin akoma nuk e kam parë por besoj se do të jetë një surprizë e bukur për të gjithë neve.

Mark Palnikaj,
Tiranë më 24 tetor 2021

Agostin Mhilli Mjeshtër i Madh

Agostin Mhilli mundesi 5 here kampion i Vllaznise, dekurohet nga Presidenti i Shqiperise Ilir Meta me titullin «Mjeshtri i Madhe», i cili dhe pse ka lindur ne Shkoder nuk mohn origjinin e tij, Dukagjinin.

Shume te aferm, miq e shoke ishin mbledhur per ta takuar Mjeshterin para Kishes së Mbretit, në Bruksel, ku bashkesia katolike shqiptare merr pjese në meshen shqip. Vendi i takimit ishte nje kafe me pronar nga Dukagjini, Gjergj Bjeshka.

Kush eshte Agostin Mhilli ose Gusti siç e njohin rrethi i afermit dhe shoket e tij. Ka lindur me 29 shtator 1963 në Shkoder, ku baba i tij, Mirash Zef Mhilli i ardhur nga fshati Malagji i Dushmanit. Eshte kjo familje, qe ka vazhduar traditen sportive me të vellain Vasin, nje nder hembollistet e pare të klubit «Vllaznia» dhe organizator i formimit të ekipit, si dhe nipi që në hapat e para të karrieres së tij, në boks në Britanin e Madhe.

Agostin Mhilli, eshte njeriu, i cili eshte kampion i mundjes së lirë, në Shqiperi, per peridhen 1986-1990, në peshen 74 kg. Fitues i dy medaljeve të Arta në spartakiaden Kombetare, por dhe i disa kupave si dhe mbajtessi i titullit «Mjeshter Sporti», që nga viti 1989.

Pas 28 vitesh nderohet me titullin e lart «Mjeshter i Madh»! Eshte nje vlersim i merituar dhe pse i vonuar, ku Agostin Mhilli shpreh emucionet e tij gjate diteve, i cili ishte ftuar per të terhequr titullin, ku shpreh falenderimet e tij ndaj kolegeve, traniereve e shokeve, që e shoqruan në tapetin e kuq të mundjes.

Nje falenderim per mediat në Shkoder, të cilet kane perciell në edicionet e tyre kete ngjarje mjaft festive per Shkodren. Agostini, në prani të miqeve e shokeve që jane emigrant në Belgjike shpreh jeten e tij në kalvarin e emigrimit si dhe tregon per gazeten «Dukagjini», se perveç jetes sportive ka pasur nje veprimtari të madhe politik në ndryshmet e medha, në fillimet e nderrimit të sistemit komunist në Shkoder. Kujton se ka shperndar numrat e pare të gazeten «Rilindja demokratike», shumë njerez ishtin të pranishem pran oborrit per të marre gazeten aq të kerkuar

në ato vite dhe pse ishte nje rrezik nga sistemi policore, që ishte në fuqi.

Kujton me nostalgji se si bashke me Rrok Bardelin kane hypur siper pallatit të Sportit, sot Katedralia e Shkodres, kane



hequr «Sirenen e alarmit» dhe kane vendosur Kryqin si dhe praninë e tij në meshen e pare e celibruar nga Dom Simon Jubani, që ishte nje nderim, nje nder per organizatoret e kesaj ngjarje historike, që solli lirin e besimit në Shqiperi.

Agostini shpreh emucionet e medha, që kishte pasur nga nje telefonat e pa pritur nga Sekretari i Presidences, per dekoraten e akorduar. Në Tiranë isha me familjen, duke pasur me vete nenen time, per të marre dekoraten. Aty ishte shumë i emocionuar, ku perveç familjareve kisha dhe shoket e mi të sportit. Kur dekorata merret nga Presidenti i Republikes së Shqiperise, eshte nje kenaqesi e veçante. Eshte nje nderim per mua, per familjen, per Shkodren dhe të gjithë emigranet që kane emigruar dhe jetojme e punojme në Belgjikë.

Zef Nika,
Bruksel, me 14 dhjetor 2021



REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
VATË DEMA

